

INTERVISTA

Si gjithmone
brilant Henri
Kisingeri



ZBULIMI

Portretet e
udheheqeve,
sipas CIA-s



RUSIA

A po ndodh një
“puç” kundër
Putinit?

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al-Gusht 2015

Revolucioni i ri kinez, po trondit ekonomine boterore





Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



Një prej “dënimeve” që merr kur refuzon të marrësh pjesë në politikë, është se përfundon duke u qeverisur nga ata që janë inferiorë ndaj teje.

Platoni

Vendi më i nxehtë në Ferr u është rezervuar atyre që qëndrojnë neutralë, në kohëra konflikti të madh moral.

Martin Luther King Jr.

Politika është luftë pa gjakderdhje, ndërkohë që lufta është politikë me gjakderdhje.

Mao Cedun

Njeriu është nga natyra një kafshë politike.

Aristoteli

Nëntëdhjetë përqind e politikanëve i japin dhjetë përqindëshit tjetër një reputacion të keq.

Henry A. Kissinger



Fundi i epokës së artë? Dragoi dikur ishte zgjidhja, tashmë është vetë problemi

Dikur ishte zgjidhja. Tani, krejt papritur ka kuptuar se është problemi. Kanë mjaftuar më pak se dy muaj, në perceptimin kolektiv, për të eliminuar tridhjetë vite rritje ekonomike. Vera e zezë e Kinës është rikthyer për të fundosur bursat, kriza shtrihet gjithandej dhe në Pekin po ngrihet në këto orë një pyetje e vetme: përse po ndodh arratia e madhe nga ajo që mbetet ekonomia e dytë më e madhe e botës, me ritme zyrtare rritjeje ekonomike dhe likuiditete, që asnjë superfuqi nuk mundet as t'i ëndërrojë? Udhëheqja e kuqe i censuron alarmet mbi “perëndimin e epokës kineze” dhe shmang pyetjet më sikletosëse, por për herë të parë përballlet me fundin e epokës së artë të kapital-komunizmit, dhe me uljen e besimit tek gjithëpushtetshmëria e partisë-shtet.

Efekti, sipas agjentëve të bursës së Shangait, është ai i një plazhisti që nuk di not, kur kupton që kamerdarja pas të cilës është kapur, po shfryhet: për ta zhytur në panik nuk ka nevojë që të shohë vendin ku është çarë, i mjafton fakti që ka nisur

të zbutet. Rënia e radhës e bursave, ka konfirmuar dje tre sinjalet më shqetësues të javëve të fundit: ndërhyrja e shtetit nuk arrin më që të rifuqizojë një treg të kontrolluar po nga shteti, investitorët nuk besojnë më, as tek rritja ekonomike pa fund e Kinës, as tek të dhënat e shpërndara nga autoritetet, qeveria të jep përshtypjen se nuk e ka më nën kontroll situatën. Që nga fillimi i korrikut, prekja magjike e dragoit duket se e ka humbur vlerën, dhe pavarësisht se zyrtarët e lartë flasin për një rritje me 7% të GDP-së për vitin 2015, si dhe injeksione të reja rekord në likuiditete, tregjet aziatike po trajtohen si “murtajat” e reja të Indekseve të bursave. Virusi quhet “besim” dhe në rastin e Kinës, infeksioni, nga ekonomik, rrezikon të shndërrohet në politik.

Elementët e një krize aziatike perfekte po lulëzojnë: fluska e pasurive të paluajts-hme, rënie e eksporteve dhe e prodhimit, zhytje e bursave dhe e kredive, zhvlerësim, inflacion shumë pranë zeros, pikiatë e çmimit të naftës dhe lëndëve të para. Ai që praktikisht mbetet ende mbuluar, është efekti shkatërrimtar i të parës krizë të madhe kineze, e shkaktuar prej vështirësive në ndryshimin e modelit të zhvillimit, pra reduktimit të rolit të shtetit, në favor të atij të tregjeve.

Presidenti Xi Jinping, tre vjet më parë erdhi në pushtet më premtimin për të kryer “reforma të tregut”. Legjitimimi i tij i kishte rrënjët jo në spastrimet antikorruption, por në “aftësinë për të ndryshuar Kinën”, duke e bërë atë “superfuqinë e shekullit”, e pasur falë modernitetit dhe besueshmërisë. Instrumenti i përshtatur deri dje, ka qenë kalimi nga eksportet me kosto të ulët, tek rritja e konsumit të brendshëm, nga punëtori në fabrikë, tek zyrtari me kollare në zyrë, përmes urbanizimit të detyruar. Realiteti që vazhdimisht përgënjeshtrohet premtimet e një dite më parë, rikthimi i kinezëve në fshatra dhe rifutja me shpejtësi e praktikave socialiste, lënë të kuptohet tashmë jo vetëm për një frenim, por për një rrugëtim reformist të Kinës, që ka dështuar pa u nisur.

Jo vetëm që në Pekin po fuqizohen kështu zërat se kriza nuk është pasojë vetëm e tregjeve të mbivlerësuar, por tashmë makthi i varfërimit po tremb nivelet më të lartë drejtues të partisë. Objektivi nuk është më prekja e fondit financiar për t’u ringritur, por ridimensionimi nga lart i pushtetit të “Maos së ri”, një vit para përfundimit të mandatit të tij të parë. Që nga parashikueshmëria ekonomike, Pekini kalon kështu në dyshimin mbi aftësinë dhe stabilitetin politik, që deri dje e kishin të garantuar: në një sistem autoritar, ndërhyrjet e bankës qendrore, agjencive të planifikimit dhe fondeve sovranë, nuk janë më të mjaftueshme për të qetësuar tregjet dhe qeveritë e huaja, në të cilat për herë të parë dhe zyrtarisht, ka nisur shprehet pasiguria për udhëheqjen e Xi Jinpingut. Një fuqi ekonomike në rrëshkitje, nuk mund të shpëtohet nga një parti-shtet që lëkundet dhe e anasjellta, Dragoi kinez pas tridhjetë vitesh hedh litarin e shpëtimit, Azia dhe Perëndimi zbulojnë se i kanë besuar pak si shumë një lokomotive e cila nuk mund të tërhiqte të gjithë, e vetme dhe përgjithmonë.

Bursat kineze, në një javë kanë djegur fitimet e një viti, tregjet në Azi-Paqësor kanë prekur fundin, valutat e Perëndimit nuk pushojnë së rëni. Më shumë se sa “sindroma kineze”, është “kundërvënia mandarine” e censurës dhe propagandës: sa më shumë që banka popullore lajmëron për likuiditete të reja në treg, ulje të rezervave të detyrueshme dhe zhbllokim të limiteve për investimet aksionare në fondet e pensioneve, aq më shumë tregjet forcojnë sigurinë për një realitet ekonomik shumë më të rëndë nga sa pranohet. Kështu, nga zgjidhje, Kina është shndërruar në problem: më shumë se sa në Shangai dhe në Hong Kong, bota sheh tani nga Pekini, më shumë se sa panikun e investitorëve, vlerëson heshtjen e udhëheqësve të Pekinit, më shumë se sa rënien e papritur të Japonisë në vitet tetëdhjetë, në mendje vijnë kujtimet e shpërthimit të papritur të BRSS-së në vitet nëntëdhjetë.

Il Fatto



Tre faktorët që e përshkallëzuan dramën kineze

NGA ELIZABETH C. ECONOMY

Gjatë muajit të shkuar, ka pasur një shumësi aktesh të “Dramës Kineze”. Paqëndrueshmëria në tregun kinez të aksioneve, zhvlerësimin i juanit, dhe së fundmi shpërthimi në magazinat e Tianxhinit, të gjitha këto e ngritën në një nivel të ri ankthin mbi Kinën.

Një pjesë e këtij ankthi është i kuptueshëm. Këto ngjarje, kanë pasoja reale- mbi të gjitha për popullin kinez. Me kërkesë të qeverisë, dhjetëra miliona kinezë rrezikuan të ardhurat e tyre, duke i investuar ato jo mbi pasuri të patundshme, por në tregun e aksioneve-ata më fatkeqët e përdorën pronën e tyre, si një kësht për të investuar në treg, dhe tashmë janë të dëshpëruar për të marrë disa lajme të mira.

Shpërthimi në depot e Tianxhinit, deri tani ka shkaktuar 121 të vdekur, më shumë se 700 të plagosur, dhe mbi 50 persona që ende rezultojnë të humbur. Globalisht, zhvlerësimi i juanit ka bërë që bankierët qendrorë në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të rimendojnë normat e interesit, ndërsa rënia në bursat kineze, ka shkaktuar një efekt zinxhir në tregjet aziatike dhe amerikane.

Ngjarje të tilla, si në çdo vend të botës, do të tërhiqnin vëmendjen ndërkombëtare. Megjithatë në rastin e Kinës, zhurma rreth tyre është përforcuar nga mungesa e tre faktorëve lehtësues:

Transparenca

Mungesa e transparencës në Kinë, e vështirëson sfidën e të kuptuarit se çfarë po ndodh realisht. Për shembull, çfarë qëndron prapa zhvlerësimit të juanit? A është kjo lëvizje, pjesë e ofertës së Pekinit për të shtyrë përpara reformat e saj ekonomike, duke e bërë monedhën më të reagueshme ndaj tregut?

A është kjo një përpjekje, për të bindur Fondin Monetar Ndërkombëtar që juani duhet të bëhet pjesë e shportës së saj të monedhave, para se Pekini të presë edhe 5 vjet të tjera që monedha e tij të merret në konsideratë në këtë drejtim? Apo është një përpjekje për të mbështetur eksportin gjithnjë e në rënie të produkteve kineze? A mos ndoshta është një ndërveprim i të trejave?

Konteksti

Ndërsa dëmi njerëzor, i shkaktuar nga shpërthimi në Tianxhin ishte shkatërrues, askush nuk duhet të jetë befasuar nga vetë katastrofa apo pasojat e saj politike. Modeli kinez i sjelljes, duke përfshirë ndikimin e sistemit të korruptuar të vlerësimit

mit mjesisor, që mundësoi vendosjen e fabrikës shumë pranë banesave të qytetarëve, mungesa e njohjes së asaj që ruhej në depo, bujaria e popullit kinez që u përpoq të ndihmonte ata që u prekën nga tragjedia, dhe vëmendja që qeveria kineze tregoi ndaj përcaktimit të fajtorëve dhe mbyllja e rrjeteve informative dhe bllokimi i komenteve të qytetarëve nëpërmjet internetit, është ai që përsërit shpesh veten.

Perspektiva

Drama që rethon Kinën, zmadhohet ndërkaq edhe nga prirja e vëzhguesve të jashtëm për të humbur një grimë perspektive. Mediat, si dhe analistët mbi Kinën, kanë dhënë deklarata dhe parashikime të guximshme. Me kujtohet se çfarë thoshin njerëzit mbi tregun kinez të aksioneve në fund të vitit 2014

Drama që rethon Kinën, zmadhohet ndërkaq edhe nga prirja e vëzhguesve të jashtëm për të humbur një grimë perspektive. Mediat, si dhe analistët mbi Kinën, kanë dhënë deklarata dhe parashikime të guximshme. Me kujtohet se çfarë thoshin njerëzit mbi tregun kinez të aksioneve në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015, kur tregu ishte në rritje të madhe

dhe fillim të vitit 2015, kur tregu ishte në rritje të madhe.

Çuditërisht, asokohe kishte shumë triumfalizëm, që u ngacmua nga disa shenja të errëta paralajmëruese. “The Economist” publikoi për shembull një artikull me titullin “Super-demi është tërbuar”, që e fokusoi në masën 95 përqind tek emocionet që po gjeneronte tregu i aksioneve, ndërsa vetëm 5 përqind dhe në fund të shkrimit përmendeshin disa nga dobësitë potenciale që mund të sabotonin rritjen e atij tregu.

Megjithatë Gywnn Guilford tek “Quartz”, që u ndal shpesh herë tek kjo temë në vitin 2014, kritikoi komentatorë të cilët theksuan rreziqet e mbështetjes së tregut kinez të aksioneve, financimet e dyshimta dhe marrëdhëniet aspakt transparente të qeverisë me publikun.

Ngjarjet dramatike, do të shkaktojnë përherë spekulime dhe komente që të lënë pafrymë, por kuptimi i vërtetë duhet të fillojë duke i kushtuar vëmendje ekspertëve të vërtetë. Në rastin e ekonomisë kineze, të lexosh studime mbi Kinën nga ekonomistë dhe analistë si Nick Lardy, Barry Naughton, Patrick Chovanec, Dan Rosen, Fraser Howie, George Magnus, Michael Pettis, dhe Victor Shih, është mënyra më e mirë për t’ia filluar.

Ata përfaqësojnë një gamë të gjerë pikëpamjesh, dhe nëse do të mblidheshin së bashku për një diskutim, do ishte e vështirë të binin në konsensus. Por nëse dikush do ketë kohë për të lexuar artikujt e tyre, në mënyrë të pashmangshme, do të jetë më i informuar mbi ekonominë kineze.

Ajo që nevojitet ndërkohë është edhe përunjësia.

Një nga diskutimet e mia të preferuara mbi zhvlerësimin e monedhës kineze, është intervista e David Dollar në “Nikkei Asian Riview”. Ai argumenton se zhvlerësimi është një “lëvizje në drejtim të një sistemi, më shumë të orientuar nga tregu, por jo një përpjekje e hapur për të nxitur eksportet”. Por, shton ai më tej: “Nëse unë e kam gabim ...”

Aftësia për të pranuar çfarë nuk dimë mbi Kinën, është së paku po aq e vlefshme sa ndarja e asaj që ne e dimë, dhe sigurisht vlen më shumë se këmbëngulja tek ajo që me mendojmë se dimë.

* Shënim: Elizabeth C. Economy është Drejtoreshë e seksionit të Azisë në Këshillin për Marrëdhëniet me Jashtë. Ajo është eksperte mbi politikën e brendshme e të jashtme kineze si dhe marrëdhëniet SHBA-Kinë.

“The Diplomat” - Bota.al



Si gjithmonë, brilant. Henry Kissingeri për realizmin, idealizmin, Kinën, Luftën e Ftohtë, Putinin, Ukrainën dhe Gjermaninë...

Kryeredaktori i “National Interest”, Jacob Heilbrunn ka zhvilluar këtë intervistë me ish Sekretarin e Shtetit të SHBA, Henry Kissinger.

Heilbrunn: Përse sot realizmi është një qasje jo e preferuar ndaj punëve të jashtme, ose të paktën jo aq i rëndësishëm se sa kur kishim figura si Hans Morgenthau, George F. Kennan, Dean Acheson, më pas ju, në vitet 1970 - çfarë ka ndryshuar?

Kissinger: Nuk mendoj se e kam ndryshuar shumë pikëpamjen time për këtë temë, që nga vitet shtatëdhjetë. Gjithmonë kam patur një ide të gjerë për interesin kombëtar, dhe pjesa më e madhe e debatit të realizmit përkundër idealizmit është artificial. Mënyra se si paraqitet tradicionalisht debati, vendos një grup që

beson tek fuqia, si elementi përcaktues i politikës ndërkombëtare, përballë idealistëve, që besojnë se vlerat e shoqërisë janë vendimtare. Kennani, Achesoni, apo cilido prej atyre që ju përmendët, nuk kishte një ide kaq thjeshtësuese. Këndvështrimi i realistëve të ndryshëm është se, në një analizë të politikës së jashtme, duhet të fillosh me vlerësimin e elementëve që kanë lidhje me situatën. Dhe sigurisht, vlerat përfshihen si një element i rëndësishëm. Debat i vërtetë është mbi prioritetin relativ dhe ekuilibrin.

Një prej gjërave që më la më shumë përshtypje, në biografinë e re për ju, që ka shkruajtur Niall Ferguson, është citimi që i bën ai ditarit tuaj personal, nga viti 1964. Ju thoshit, në mënyrë disi profetike, se “fitorja e Goldwaterit është një fenomen i ri në politikën amerikane - triumfi i palës ideologjike në kuptimin evropian. Askush nuk mund ta parashikojë si do të përfundojë, për arsye se nuk ka asnjë precedent”.

Në Konventë, për dikë si puna ime, që e njihite mirë politikën e Estblishmentit Lindor, u duk mëse e vërtetë. Më vonë në jetë, arrita ta njoh Goldwater-in dhe ta respektoja si një njeri me bindje të forta morale dhe integritet të lartë. Dakord, por isha më shumë i interesuar për interpretimin tuaj të forcës ideologjike, që u shfaq në vitin 1964.

Ishte një forcë e re ideologjike në Partinë Republikane. Deri atëherë, pikëpamja e Estblishmentit Lindor, e bazuar mbi modelet historikë të historisë së Europës, ishte dominuese në politikën e jashtme. Kjo politikë e re e jashtme ishte më misionare; ajo vinte theksin në faktin që Amerika kishte një mision për të sjellë demokraci - nëse ishte e nevojshme, edhe duke përdorur forcën. Dhe kishte një lloj mungese tolerance ndaj kundërshtuesve. Më pas, kjo u bë karakteristike, edhe e të djathtës ekstreme, edhe e të majtës ekstreme, dhe këto ndryshonin kah herë pas here.

Dhe të dyja këto e sulmonin furishëm administratën Nixon.

Po.

Më kujtohet që në “Kujtimet” tuaja, ju shkruani se keni qenë ndoshta më i habitur, që sulmohenit nga e djathta...

Isha krejt i papërgatitur.

... Akuzoheshit për zbutje ndaj Bashkimit Sovjetik.

Po, dhe disa si Norman Podhoretz - që sot është një mik i mirë - më sulmonin nga e majta dhe nga e djathta, në mënyrë të njëpasnjëshme.

Kisha harruar që ai e zotëronte atë aftësi. Megjithatë, në fund, politika e “détente”-s (uljes së tensionit), luajti një rol kritik në shembjen e Bashkimit Sovjetik, apo jo?

Kjo është pikëpamja ime. Ne e shihnim détente- n si një strategji në konfliktin me BS.

Jam shumë i habitur që kjo gjë nuk merr më shumë vëmendje - në Europë, kjo është ideja e përhapur, pra që détente-ja ishte thelbësore, në drejtim të zbutjes së Europës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik, dhe lënies pas të kujtimit të Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që në SHBA ne kemi një pikëpamje triumfaliste.

Këtu në SHBA, ne kemi idenë që Reagani e nisi procesin me fjalimin e tij të famshëm të “Perandorisë së të Keqes”, i cili sipas mendimit tim, u mbajt kur tashmë Bashkimi Sovjetik e kish marrë tatëpjetën. Ne ishim të angazhuar në një luftë kohëgjatë, duke prodhuar shumë analiza konkurruese mes tyre. Unë isha në anën e vijës së ashpër të analizës. Por unë vija theksin edhe në dimensionet diplomatike dhe psikologjike. Ne duhej ta zhvillonim Luftën e Ftohtë, nga një pozicion ku nuk do të ishim të izoluar, dhe ku do të kishim bazat më të mira të mundshme për të hyrë në konflikte të pashmangshme. Në fund, ne kishim një detyrim special për të gjetur një mënyrë për shmangien e konfliktit bërthamor, duke qenë se ai e rrezikonte qytetërimin. Ne kërkuam një pozicion, për të qenë të gatshëm

të përdornim forcën kur ishte e nevojshme, por gjithmonë duke demonstruar qartë, se do të ishte mjete i fundit. Neokonservatorët patën një ide më absolutiste. Reagani përdori hapësirën e kohës që kishte në dispozicion, me aftësi taktike të konsiderueshme, ndonëse nuk jam i sigurtë nëse e gjitha ishte e paramenduar. Por efekti i saj ishte tejet mbresëlënës. Unë mendoj se periudha e détente-s ishte një prelud i domosdoshëm.

Arritja tjetër monumentale ishte padyshim, hapja me Kinën. A e ndieni sot këtë gjë? Reduktimi i rolit të sovjetikëve në Lindjen e Mesme. Kjo nuk ishte e paktë.

Saktë. Dhe shpëtimi i Izraelit në luftën e vitit 1973, me furnizimin me armë.

Të dyja ishin të lidhura mes tyre.

A është Kina, Gjermania Vilhelmiane e kohëve të sotme? Richard Nixoni, pak para se të vdiste, i tha William Safires se ishte e domosdoshme të krijohej një hapje me Kinën, por mund të kemi krijuar një Frankenstein.

Një vend që ka dominuar për tre mijë vite rajonin e tij, mund të thuhet se ka një realitet të qenësishëm. Alternativa do të kish qenë të mbahej përgjithmonë Kina e nënshtruar, në marrëveshje të fshehtë me Bashkimin Sovjetik, e si pasojë të bëhej Bashkimi Sovjetik - tashmë një vend bërthamor i përparuar - vendi dominues në Eurazi, me miratimin e heshtur të Amerikës. Por Kina paraqet një sfidë themelore për strategjinë amerikane.

Dhe a mendoni se ata po përpiqen të shkojnë drejt një bote më Kinocentrike, apo mundet që të integrohen në një lloj kuadri Vestfalian, siç shkruani dhe ju në librin tuaj më të fundit, “Rendi Botëror?”

Kjo është sfida. Kjo është pikëpyetja e madhe. Është detyra jonë. Nuk dimë ta bëjmë mirë, sepse nuk e kuptojmë historinë dhe kulturën e tyre. Mendoj se mënyra e tyre themelore e të menduarit, është Kinocentrike. Por mund të prodhojë pasoja me impakt global. Kështu që, sfida e Kinës është një problem më delikat se sa ai i Bashkimit Sovjetik. Problemi sovjetik ishte kryesisht strategjik. Kjo është një çështje kulturore: A mundën dy qytetërime, që të paktën për momentin nuk mendojnë njësoj, të arrijnë tek një formulë bashkëjetese që prodhon rend botëror?

Sa shanse ka, sipas jush, për një afrim Kino-Rus?

Mendoj se nuk është në natyrën e asnjërit prej tyre.

Sepse rusët, është e qartë që do të donin të krijonin një marrëdhënie shumë më të ngushtë.

Por pjesërisht sepse ne ua kemi krijuar mundësinë e zgjedhjes.

Si mendoni se mund të dalin Shtetet e Bashkuara nga qorrsoaku i Ukrainës?

Problemi nuk është që të dalin SHBA nga qorrsoaku i Ukrainës, por të zgjidhet ai, në një mënyrë që shkon në favor të rendit botëror. Duhet pranuar disa gjëra. Së pari, marrëdhënia mes Ukrainës dhe Ruisë do të ketë gjithmonë një vend special në mendjen e rusëve. Nuk mund të kufizohet asnjëherë në një marrëdhënie mes dy shtetesh tradicionalisht sovranë, jo nga këndvështrimi i Ruisë, dhe ndoshta as nga këndvështrimi i Ukrainës. Kështu që, ajo që ndodh në Ukrainë, nuk mund të vendoset në një formulë të thjeshtë të zbatimit të parimeve që funksionuan në Europën Perëndimore. Në këtë kontekst, duhet të analizojmë se si ndodhi kriza në Ukrainë. Është e pamendueshme, që Putini shpenzon gjashtëdhjetë miliardë Euro për të shndërruar një vendpushim veror, në një fshat dimëror Olimpik, me qëllim që të nisë një krizë ushtarake një javë më vonë, pas përmbylljes së një ceremonie, e cila e paraqiste Ruisë si pjesë të qytetërimit Perëndimor. Kështu që, duhet të pyesim: si ndodhi? Unë e kam takuar Putinin në fund të nëntorit 2013. Ai ngriti një sërë shqetësimesh; Ukrainën e renditi në fund, si një problem ekonomik që Rusia do ta zgjidhte përmes tarifave dhe çmimeve të naftës. Gabimi i parë ishte sjellja e pavëmendshme e Bashkimit Europian. Ata nuk kuptonin pasojat e disa prej kushteve të tyre. Politika e brendshme ukrainase,

e bëri të dukej e pamundur për Yanukovichin, që të pranonte kushtet e BE dhe të rizgjidhej, apo për Rusinë që t'i shihnte si thjeshtë ekonomikë. Kështu që presidenti i Ukrainës, i refuzoi kushtet e BE. Europeanët i kapi paniku, dhe Putini fitoi vetëbesim të tepruar. Ai e rroku si një mundësi të artë për të implementuar menjëherë, atë që deri në ato momente kish qenë objektivi i tij afatgjatë. Putini ofroi 15 miliardë dollarë, për të tërhequr Ukrainën në Unionin e tij Euraziatik. Në të gjithë këtë, Amerika qëndroi pasive. Nuk pati diskutime politikë domethënës me Rusinë apo BE-në, apo për atë që po ndodhte. Secila palë veproi në një farë mënyre racionalisht, por bazuar mbi keqkuptimet për palën tjetër, ndërkohë që Ukraina rrëshkiti në sheshin Maidan, pikërisht ndërsa Putini kish dhjetë vite që punonte për të ndërtuar njohjen e statusit të Ruisë. Padyshim që në Moskë menduan se Perëndimi po përpiquej të shfrytëzonte, atë që ishte perceptuar si një festival rus, për të larguar Ukrainën nga orbita e Ruisë. Më pas, Putini nisi të veprojë si një car rus - si Nikolla I, më shumë se një shekull më parë. Nuk po justifikoj taktikat, vetëm po i vendos në kontekst.

Një tjetër vend që me sa duket ka marrë rol udhëheqës në Europë është Gjermania - për Ukrainën, për Greqinë...

Ata nuk e kërkojnë atë rol. Paradoksi është që, 70 vjet pasi u mundën pretendimet e Gjermanisë për të dominuar Europën, tashmë fitimtarët, kryesisht për arsye ekonomike, po i luten Gjermanisë që të dominojë Europën. Gjermania mundet dhe duhet të luajë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e rendit europian dhe ndërkombëtar. Por, Gjermania nuk është partneri ideal negociator për sigurinë e Europës, në një kufi që ndodhet 200 milje larg Stalingradit. SHBA nuk ka parashtruar një koncept të vetin, përveç se që Rusia një ditë do i bashkohet komunitetit botëror, përmes një lloj akti konvertimi automatik. Roli i Gjermanisë është i rëndësishëm, por një kontribut amerikan ndaj diplomacisë për Ukrainën është thelbësor për ta vendosur problemin në një kontekst global.

Atëherë, a është gabim kjo mungesë e Amerikës?

Nëse e trajtojmë Rusinë si fuqi e madhe, atëherë duhet që, në një fazë të hershme, të vendosim nëse shqetësimet e tyre janë të pajtueshëm me nevojat tona. Duhet të eksplorojmë mundësitë e një statusi grupimi joushtarak në territorin mes Ruisë dhe kufijve ekzistues të NATO-s. Perëndimi heziton që të marrë frenat për rimëkëmbjen ekonomike të Greqisë; dhe sa për Ukrainën, sigurisht që nuk do të ndërmarrë nisma njëpalëshe. Kështu që, të paktën duhet ekzaminuar mundësia e një lloj bashkëpunimi mes Perëndimit dhe Ruisë, në një Ukrainë të pareshtuar ushtarakisht me askënd. Kriza e Ukrainës po shndërrohet në tragjedi, për arsye se po ngatërron interesat afatgjatë të rendit global, me nevojën imediate të rikthimit të identitetit ukrainas. Unë jam në favor të një Ukraine të pavarur në kufijtë e saj ekzistues. E kam mbrojtur këtë ide, që nga fillimi i periudhës postsovjeteke. Por, kur lexon tashmë, se njësi myslimane po luftojnë në emër të Ukrainës, atëherë kupton që sensi i proporcionit është humbur.

Eshtë fatkeqësi, natyrisht.

Për mua po. Do të thotë se thyerja e Ruisë është shndërruar në objektivi; në fakt, objektivi afatgjatë duhet të jetë integrimi i saj.

Të kthehemi tek historia, cili është vlerësimi juaj për rolin e Gjermanisë në Europë sot? A jemi rikthyer tek një problem i ri gjerman, ku Europa jugore i sheh si një fuqi pushtuese, dhe brenda Gjermanisë ka shenja nacionalizmi?

Ka shenja. Disa grupe në Gjermani, ata nën 50 vjeç, ndonjëherë veprojnë sikur vendi që dikur përpiquej t'i jepte formë Europës me forcë, tani pretendon të drejtën që ta riformësojë Europën përmes gjykimit moral absolutist. Eshtë e padrejtë të joshësh Gjermaninë në një rol të tillë. Eshtë politikë e brendshme e kollajtë për vendet e Europës jugore, që të fajësojnë Gjermaninë dhe jo vetveten. Cili është mëkati i Gjermanisë në Greqi? Gjermanët po përpiquej të përcaktojnë një proces të përgjegjshëm të rimëkëmbjes. Duke patur parasysh që historia e ka

shndërruar në makth inflacionin për gjermanët, unë e mbështes pozicionin e tyre. Gjermania, kurrë në historinë e saj që nga 1871, nuk ka drejtuar një sistem ndërkombëtar. Nga 1871 deri në 1890, Bismarku bëri një tour de force spektakolar, që ishte i papërballueshëm. Nuk mund të kesh një politikë të madhe, nëse ajo kërkon një gjeni për çdo brez. Por nga 1890 deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore, Gjermania ka qenë e mposhtur, në konceptin e botës që e rrethonte. Britania dhe Franca kanë shumë më tepër përvojë në diplomacinë shumëpalëshe. Ato mund të ndihmojnë, mund të jenë vendimtare në ndihmën e tyre, por ato kanë nevojë për një kuadër më të madh dhe më global, pr të cilin ne duhet të kontribuojmë.

Brezi i Atlanticistëve në Gjermani dhe qasja që ai mishëronte, janë zhdukur. Eshtë për të ardhur keq. Politikanët më të rinj të CDU-së që kam takuar, nuk janë aq të interesuar për SHBA. Ky është një ndryshim dramatik, duke patur parasysh që e gjithë politika e Adenauerit bazohej mbi *ëestbindung-un* (orientimin nga Perëndimi). Eshtë pjesërisht faji i tyre dhe pjesërisht faji ynë.

Kohët e fundit kam takuar Robert McFarlane, i cili ka punuar për ju dhe në administratën Reagan. Ai më tha: “Mendimtari fundit strategjik si president i SHBA ka qenë Richard Nixoni”. A është e vërtetë?

Mendoj që është e vërtetë. Ai kishte një vizion strategjik thelbësor. Në fundin e vëllimit të parë të kujtimeve të mia, “Vitet në Shtëpinë e Bardhë”, unë kam shkruajtur se pyetja është: Cfarë do të kishte ndodhur, nëse establishmenti të cilit Nixoni edhe i druhej, edhe e admironte, do të kish shfaqur pakëz dashuri? A do të ishte tërhequr ai më shumë në egërsinë e pakënaqësive të tij, apo mos vallë një akt i tillë do ta kishte çliruar Nixonin? E lë të hapur.

A e shihni burimin e shumë prej problemeve të politikës së jashtme të Amerikës, tek Vietnami, tek ajo prishje e konsensusit për politikën e jashtme?

Mendoj se Vietnami ishte preteksti. Ai e bëri protestën legjitime. Sepse në fund të fundit, kishte demonstrata studentësh në Holandë, e cila nuk kish problemin e Vietnamit, dhe në Francë.

Nixoni ishte dikush që kishte përvojë shumë të madhe me politikën e jashtme, përpara se të bëhej president, në vitin 1969.

Ai mendonte thellë, qasja psikologjike e bënte jo të gatshëm të merrej me shumë njerëz, kështu që i duhej të mendonte dhe lexonte - ai nuk mundej të shtypte një buton dhe të merrte një përgjigje nga Google. I duhej edhe të udhëtonte shumë. Ai nuk ndihej i kërcënuar personalisht kur udhëtonte jahstë vendit, kështu që ndihej i lirshëm në biseda me udhëheqës të huaj. Për të gjithë këto arsye, mendonte thellësisht për punët e jashtme.

Duhet të ketë mësuar shumë edhe nga Eisenhoweri, apo jo.

Shikoni, si çdo gjë tjetër e Nixonit, ishte një kombinim i mirë i pakënaqësive dhe admirimit. A mendoni se Barack Obama është një realist - ai heziton të përfshihet në Ukrainë, për shembull - apo mendoni se është e tepruar?

Nga pikëpamja e maturisë, ai është realist. Por vizioni i tij është më shumë ideologjik, se sa strategjik.

Ju faleminderit për intervistën.

National Interest



Saktësia e portreteve psikologjike të CIA-s: Nga Hitleri, tek Kastro, Kadafi dhe Sadami

Profilat sekrete psikologjike e diktatorëve dhe liderëve botërorë nga ana e CIA-s janë të habitshëm. Psikanalizimi i njerëzve të fuqishëm, nga Fidel Castro tek Saddam Husseini

Ditë më parë, Politico dhe USA Today raportuan rreth një studimi sekret të vitit 2008 nga ana e Pentagonit, që konkludonte se karakteristika përcaktuese e Presidentit rus Vladimir Putin është... autizmi. Projekti Body Leads i The Office of Net Assessment vlerësonte se rrëmimi në orë të tëra i videove të Putinit zbulonte “se Presidenti rus ka një anormalitet neurologjik... e identifikuar nga neuroshkencëtarë të shquar me emrin Asperger’s Syndrome, një çrregullim autik që i prek të gjitha vendimet e tij”. Zëdhënësi i Putinit e hodhi poshtë pretendimin si “budallallëk që nuk ia vlen të komentohet”. Por kjo është larg nga të qenit hera e parë që komuniteti i inteligjencës është orvatur të diagnostikojë udhëheqës të huaj nga larg për llogari të diplomatëve dhe politikanëve amerikanë. CIA ka një histori të gjatë në realizimin e profileve psikologjike dhe politike të figurave ndërkombëtare, me shkallë të ndryshme thellësie dhe saktësie. Më poshtë kemi një përmbledhje të vockël të orvatjeve për t’u future në kokët e krerëve të shteteve:

Adolf Hitleri

Në vitin 1943, Office of Strategic Services, pararendësja e Luftës së Dytë Botërore e CIA-s, ngarkoi Henry A. Murray e Harvard Psychological Clinic që të vlerësonte personalitetin e Hitlerit bazuar në vëzhgime të kryera nga larg.

Gjetje: Në një vlerësim të pamëshirshëm prej 240 faqesh, Murray dhe kolegët e tij konkluduan se Hitleri ishte një narcizist neurotik i pasigurtë, impotent, mazokist dhe vetëvrasës që e shikonte veten si “shkatërruesin e një superegoje të vjetëruar kristiane hebraike”. Gjithjashtu: Ka pak mosmarrëveshje midis psikologëve profesionistë apo edhe amatorë se personaliteti i Hitlerit është shembull i një tipi kundëraktiv, një tip i shënuar nga përpjekje intensive dhe kokëforta për të mundur paaftësi, dobësi dhe poshtërimë (dëmtime ndaj vetëvlerësimit) të hershme dhe nganjëherë nga përpjekje për të hakmarrë dëmtime dhe fyerje ndaj krenarisë. Raporti deklaronte se Hitleri kishte vuajtur nga “verbimi hysterik” ndërkohë që ishte ushtar në Luftën e Parë Botërore. “Kjo sëmundje psikosomatike ishte e lidhur me humbjen finale e nënës Gjermani dhe qe pasi dëgjoji kapitullimin e saj që ai pati vizionin e detyrës së tij si shpëtimtar. Papritmas shikimi i erdhi”. Vazhdon më tej: Seksualisht ai është një mazokist i plotë... Fantazia e fshehtë heteroseksuale e fshehur për një kohë të gjatë e Hitlerit është ekspozuar nga analiza sistematike dhe korelacioni i 3000 metaforave të çuditshme që ai përdor tek Mein Kampf... e megjithatë, vetë Hitleri është impotent. [shkrimi i pjerrët në origjinal]. Ai është i pamartuar dhe miqtë e vjetër të tij thonë se është i paaftë që ta konsumojë në mënyrë normale aktin seksual. Dosja parashikonte 8 finale të mundshme për Fyhrerin, përfshi kalimin në çmenduri, sakrifikimin e vetes në betejë, parashikimin se do të vritej nga një vrasës hebre dhe kryerjen e vetëvrasjes: “Hitleri ka deklaruar shpesh do të kryente vetëvrasje nëqoftëse planet e tij dështonin; por nëqoftëse zgjedh këtë kurs, atëhere do ta bënte një gjë të tillë në momentin e fundit dhe në mënyrën më dramatike të mundshme... Për ne do të ishte një rezultat i padëshiruar”.

Fakt qesharak: Në vitin 1972, autori parësor i studimit, psikanalisti Walter Langer, i botoi gjetjet e tij si libër, të titulluar The Mind of Adolf Hitler. Ai u bë një libër i shumëshitur.

Ho Chi Minh

CIA e studioi udhëheqësin dhe revolucionarin vietnamezoverior në vitet Pesëdhjetë.

Gjetje: Raporti mbetet i klasifikuar, por një artikull i vitit 1994 nga Thomas Omestad tek Foreign Policy (jo online) citon një marins në pension i cili e lexoi atë teksa punonte me agjencinë. Burimi i tha Omestad se CIA i keqlexoi motivacionet dhe objektivat e Ho-së.

Një produkt i Luftës së Ftohtë, profili “ekzagjeronte marksizmin e Ho-së dhe nënvlerësonte nacionalizmin e tij të zjarrtë”. Nikita Hrushov

CIA e profiloj Kryeministrin sovjetik përpara takimit të tij të vitit 1961 në Vjenë me Presidentin John F. Kennedy. Leximi lidhur me kundërshtarin e tij e bëri JFK-në të futej në profilet e personalitetit të CIA-s, sidomos të “sekreteve të kripura rreth liderëve të huaj”, sipas historianit Michael Beschloss. Edhe sovjetikët e profiluan gjithashtu Kennedy për Hrushovin, duke e përshkruar atë si një “pragmatist tipik, liberalizimi i të cilit është relativ”.

Gjetje: CIA e portretizonte Hrushovin si “një fshatar të pagdhundur që pëlqente të ishte i paparashikueshëm dhe me dy fytyra”, shkruajtën Gunter Bischof dhe Martin Kofler në një libër lidhur me samitin. Dosja e përshkruante atë si: Një aktor amator që luan në mënyrë të çfrenuar, i cili nganjëherë i ilustron pikat e tij me llojin më krudo të humorit të rrugës, Hrushovi është i pajisur nganjëherë me dinjitet personal të konsiderueshëm. Ai ka një aftësi vërtet të pazakontë për të projektuar forcën e personalitetit të fuqishëm të tij... Ai është në mënyrë të tepruar i ndjeshëm ndaj përcmimeve – reale apo të imagjinuara, të drejtpërdrejta

ose jo të drejtpërdrejta – ndaj vetes, besimit politik apo vendit të tij, ku të gjitha i shikon pakashumë në mënyrë të shkëmbyeshme... I aftë për ndershmëri të jashtëzakonshme dhe në sytë e tij padyshim i ndershëm në mënyrë të pazakontë, Hrushovi mund të jetë me raste një bixhozçi dhe një ekspert simulant në bllof të kalkular. Shpesh është e vështirë të dallosh kur Hrushovi po shpreh bindje reale dhe kur po simulon... Gjithashtu, është e vështirë të tregosh me Hrushovin nëse zemërimi i tij është real apo i shtirur... Ai është më pak i aftë që ta fshehë zemërimin e tij të mrekullueshëm kur është i lodhur...

Fidel Castro

Stafi psikiatrik i CIA-s botoi një raport sekret lidhur me liderin kubanez në dhjetor të vitit 1961.

Gjetje: Fidel Castro nuk është i “çmendur”, por është aq shumë neurotik dhe i paqëndrueshëm si personalitet, sa që është hoxha i prekshëm ndaj disa llojeve të caktuara të presionit psikologjik. Elementët e jashtëzakonshëm neurotikë në personalitetin e tij janë etja për pushtet dhe nevoja e tij njohjen dhe adhurimin e masave...

Castro ka një nevojë konstante për t’u rebeluar, për të gjetur një kundërshtar dhe për ta zgjeruar pushtetin personal të tij nëpërmjet përmbysjes së autoritetit ekzistues. Kurdoherë që koncepti për veten i tij preket pak nga kritika, ai bëhet aq i paqëndrueshëm emocionalisht sa që e humbet deri në një farë mase kontaktin e tij me realitetin... Egoizmi është thembra e Akilit e Castro.

Menachem Begin dhe Anwar Sadat

Në pritje të bisedimeve të Camp David të vitit 1978, Presidenti Jimmy Carter i kërkoi CIA-s që ta ndihmonte me profilet psikologjike e Kryeministrit izraelian Begin dhe Presidentit egjiptian Sadat. Pas bisedimeve, Carter e lavdëroi agjencinë për dosjet e hartuara: “Pasi kam kaluar 13 ditë me të dy personat, nuk do t’u ndryshoja as edhe një fjalë dosjeve”.

Gjetje: Sadat ishte një njeri me vizion të gjerë, ndërsa Begin ishte më i dhënë pas detajeve, por që të dy e kanë vullnetin për të negociuar. CIA raportonte: Vetëbesimi dhe vlerësimi special që Sadat ka për veten e tij ka qenë instrumental në zhvillimin e kësaj politike të jashtme novatore, ashtu siç ka qenë fleksibiliteti dhe aftësia e tij për të dalë jashtë izolimit kulturor të botës arabe. Ai e sheh veten si strateg të madh dhe do të bëjë lëshime taktike nëqoftëse është i bindur se objektivat e përgjithshme të tij do të arrihen... Vetëbesimi i tij i ka mundësuar që të realizojë iniciativa kurajoze, shpesh duke i hedhur poshtë objeksionet e këshilltarëve të tij. Profili e përshkruante dëshirën e Sadat për të qenë në qendër të vëmendjes si “sindromën Barbara Walters” dhe “kompleksin e Çmimit Nobel” të tij, nga ana tjetër, kujton Jerrold M. Post, psikiatri që hapi Degën Profilizuese të CIA-s Begin dallohej nga “parapëlqimi i tij për saktësinë dhe ligjshmërinë”. Profili i CIA-s i tij nënvizonte se “Begin beson që takimet ballë për ballë midis udhëheqësve botërorë mund të sjellin ndryshime në qasjet e tyre ndaj problemeve ndërkombëtare komplekse dhe në dukje jo të trajtueshëm”.

Moammar Kaddafi

Në fillimin e viteve Tetëdhjetë, CIA u orvat që të kuptonte njeriun e fortë libian, veprimet e paparashikueshme të të cilit po e frikësonin administratën Reagan.

Gjetje: Bob Woodward citon tek Veil, libri i tij për CIA-n: Pavarësisht besimit popullor për të kundërtën, Kaddafi nuk është psikopat dhe në pjesën më të madhe është në kontakt me realitetin... Kaddafi gjykohet se vuan nga një çrregullim personaliteti i fortë - një “personalitet emocionalisht të paqëndrueshëm”... Nën stres të fortë, ai është subjekt i një sjellje të çuditshme kur gjykimi i tij mund të jetë difektoz.

Një profil i mëpasëm i udhëheqësit libian nga ana e CIA-s, shkruan Woodward, ia atribuonte sjelljen e tij “një afrimi apo një krize aktuale të moshës së mesme”.

(Fakt i lezetshëm: Pasi kuptoi se Presidenti Ronald Reagan nuk ishte ndonjë le-

xues i madh, CIA nisi t'ia paraqesë atij profilet e udhëheqësve si video me narracion dhe muzikë).

Saddam Hussein

Në vitin 1990 Jerrold Post, themeluesi i tashmë të zhdukurës Center for the Analysis of Personality and Political Behavior të CIA-s, paraqiti “një profil psikologjik politik gjithëpërfshirës” të Saddam to the përpara Armed Services Committee të Dhomës së Përfaqësuesve.

Gjetje: Etiketat “i çmenduri i Lindjes së Mesme” dhe “megalomani” shpesh i janë ngjitur Saddam, por në fakt nuk ekziston asnjë provë se ai po vuante nga ndonjë sëmundje psikotike. Etja për pushtet për vete dhe Irakun nga ana e Saddam është e pakufishme. Në fakt, mendja e tij, fati i Saddam dhe i Irakut janë një dhe pandarë... Në ndjekje të ëndrrave mesianike të tij, nuk ka ndonjë dëshmi se është kufizuar nga vetëdija. Ai përdor çfarëdo force që është e nevojshme; besnikëria e vetme e tij është ndaj Saddam Hussein. Në ndjekjen e objektivave të vet, Saddam e përdor agresionin në mënyrë instrumentale. Ai përdor çfarëdo force që është e nevojshme dhe, nëqoftëse e gjykon të arsyeshme, do të shkonte në ekstremet e dhunës, përfshi përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë... Ndërkohë që nuk është psikopat, ai ka një orientim paranojak të fuqishëm... Saddam nuk ka kurrfarë dëshire për t'u bërë martir dhe mbijetesa është prioriteti numër një i tij. Një pragmatist revolucionar i vetëshpallur, ai nuk e do një konflikt në të cilin Iraku do të dëmtohej rëndshëm dhe statura e tij si udhëheqës do të shkatërrohej... Saddam nuk do të vdiste në bunkerin e fundit në flakë nëqoftëse do ta kishte një rrugëdalje, por mund të jetë jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe nuk do të ndalej përpara asgjëje nëqoftëse mbështetet me shpatulla pas muri.


Jean-Bertrand Aristide

Në vitin 1991, CIA bëri një profil psikologjik të klasifikuar të Presidentit haitian, i cili sapo ishte përmbysur nga një grusht shteti ushtarak. Teksa Administrata Clinton përgatitej që ta rikthente atë në postin e tij në 1994, agjencia ia tregoi profilin anëtarëve të Kongresit, duke shkaktuar një fushatë për t'ia hequr mbështetjen amerikane udhëheqësit të mërguar.

Gjetje: Sipas profilit, Aristide vuante nga depresioni maniak, kishte kërkuar trajtim në një spital të Montrealit në fillimin e viteve Tetëdhjetë dhe po merrte një ilaç antipsikotik të fuqishëm. Gjithashtu, CIA pretendonte se Aristide ishte i prirur nga dhuna dhe mund të kërkonte të vriste kundërshtarët politikë të tij pas rikthimit në pushtet. Bazuar në pretendimet e CIA-s, Senatori Jesse Helms (Republikan i shtetit North Carolina) e sulmoi hapur Aristide si “psikopat” dhe “vrasës i demonstrueshëm”. Megjithatë, spitali në fjalë tha se ai nuk kish qenë kurrë pacient i tij dhe vetë Aristide e mohoi se ishte në ilaçe psikotike. “Ata thanë gjëra më të këqija për Martin Luther King”, vërente ai. “Si psikolog, unë di lidhur me karakterin vrastar dhe rreth luftës psikologjike”.

Duke e rishikuar episodin në Foreign Policy, Thomas Omestad konkludonte se ai ishte një pikë e zezë në reputacionin e agjencisë për profilimin nga larg: “Nëqoftëse vendimmarrësit politikë do të vazhdojnë të kërkojnë profile, ata gjithashtu duhet t'i kërkojnë CIA-s që t'i bëjë ato siç duhet”.

(nga Mother Jones)



A po ndodh një “puç” kundër Vladimir Putinit?

Më së paku, një lloj lufte për pushtet po ndodh, dhe duket të ketë Putinin si objektiv. Modeli i sulmit është klasik: të rrëzojë në fillim mbështetësit djalit të madh. Ndonëse disa argumentojnë se çdo udhëheqje e re që mund të vijë nga Byroja Politike 2.0, do të jetë po aq e keq sa Putini, komentatori rus Andrej Piontovski mendon ndryshe. Ai pretendon se anëtarët e elitës ruse, kanë dërguar sinjale në Perëndim se “çdo gjë do të zgjidhet në javët e ardhshme”

NGA PAUL RODERICK GREGORY

Një çerek shekulli pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, njohësit e thellë të Kremlinit ndjejnë se njëfarë puçi po kurdiset në fshehtësi, pavarësisht nga pëlqyeshmëria dërmuese e qytetarëve rusë ndaj Vladimir Putinit. Zërat të ndryshëm thonë se elita e Kremlinit, e quajtur nga disa si Byroja Politike 2.0, është duke vendosur nëse Putin duhet të largohet nga pushteti, para se ai të përkeqësojë më tej situatën.

Themeluesi i së përditshmes së respektuar “Kommersant”, parashikon se një ndryshim dramatik është gati të ndodhë në vend, dhe këshillon rusët që kanë

synim të largohen nga vendi për një muaj apo më shumë, të marrin me vete edhe fëmijët e tyre.

Dështimet e Putinit janë duke u bërë përditë e më të dukshme. Askush nuk e mohon më, se Rusia është një shtet kleptokratik, liderët e së cilës kanë vjedhur pjesë të mëdha të pasurisë kombëtare. Por Rusia është shndërruar gjithashtu në një shtet gangster, që thyen normat e rendit ndërkombëtar, gënjen ditën për diell, dhe u detyrohet shuma të mëdha në gjykatat ndërkombëtare.

Kremlini i Putinit, nxit dhe mbështet një vizion mbi botën, që i bën liderët botërorë të kruajnë kokën në ankth. Politikat ekonomike të Putinit janë katastrofike. Megjithë premtimet për diversifikimin e ekonomisë, Rusia mbetet një petro-shtet në mëshirën e çmimit të naftës. E goditur nga një stuhë e përsosur e rënies së çmimeve të naftës, sanksionet ndërkombëtare dhe embargoja e vetë-imponuar, ekonomia ruse ndodhet në 3-tremujorin e gjashtë të recesionit, me vetëm një rritje mjerane në horizont. Standardet e jetesës po bien, pavarësisht premtimeve të Putinit për stabilitetin dhe prosperitetin. Rënia e investimeve ka zbehur edhe perspektivën e së ardhmes ekonomike të Ruisë. Vetëm burokracia e Putinit duket se po mbijeton e padëmtuar. Rezervat e valutës po pakësohen ndjeshëm. Shumë pak ka mbetur për ditët e këqija, dhe dhuratat e Putinit po mbarojnë edhe për miqtë e tij.

Çfarë ka marrë populli rus në këmbim? Ka fituar Krimenë, të cilën shumë rusë e besojnë se i takon Nënës Rusi. Vrulli agresiv i Putinit, ka tërhequr vëmendje, ka shkaktuar dhe frikë. Planet e tij për t'ia kthyer Ruisë statusin e superfuqisë, ka kënaqur ata që u turpëruan nga shembja e Bashkimit Sovjetik. Shumë rusë janë një pre e lehtë për propagandën e Putinit, se Perëndimi i lakmon burimet natyrore të Ruisë dhe planifikon që ta sulmojë vendin, me konfliktin në Ukrainë si hapi i parë në realizimin e këtij plani të lig.

Ata besojnë se transkriptet e dy agjentëve të pretenduar të CIA-s, që komplotonin (të maskuar duke folur në theksin rus), për të rrëzuar avionin MH17, janë një nga intrigat më të liga dhe të komplikuara në histori. Prindërit dhe bashkëshortët rusë duhet të varrosin fshehurazi të dashurit e tyre, të vvarë në fushëbetejën ukrainase.

Ndryshe nga popullit rus, Byroja Politike e Ruisë 2.0, e kupton gjendjen e vërtetë të ekonomisë, duke pranuar se ekonomistët vendas, në kundërshtim me pretendimet e mëparshme, nuk janë magjistarë. Ekonomia ruse, e cila e kishte ndaluar rritjen edhe para aneksimit të Krimesë, do të mbetet e zhytur në recesion, derikur çmimet e naftës të ringrihen, duke vazhduar për shumë vite në këtë rrugë. Kompanitë me borxhe të shumta të Ruisë, s'mund të marrin dot hua, dhe Kina nuk do dhe s'mund t'u vijë në ndihmë për t'i shpëtuar. Embargoja e Kremlinit ndaj simporteve ushqimore e ka rritur inflacionin mbi 15 përqind, më shumë sesa 3-fishi i çfarëdolloj indeksimi të pagave dhe pensione.

Në fjalimin e drejtpërdrejtë vjetor para popullit rus, Putin mundi të shprehte vetëm shpresën për një rimëkëmbje të ekonomisë botërore, porse qytetarët nuk duhet të shqetësohen, pasi ekipi i tij ekonomik ka gjithçka nën kontroll. Politbyroja 2.0 s'mund të gjejë shumë aspekte pozitive, as në politikën e jashtme të Putinit. Ai e pushtoi Krimenë pa asnjë të shtënë të vetme, por gadishulli kushton miliarda dollarë, dhe po zhytet në një moçal korrupsioni. Megjithëse mbështetja perëndimore për Ukrainën ka qenë më pak sesa efektive, Perëndimi nuk e ka braktisur gjithësesi Kievin, dhe duket i gatshëm ta furnizojë atë me para për të ecur më tej. Lufta e Putinit ka krijuar tek e fundit një Ukrainë të bashkuar, që do e urrejë Ruisë për brezat që do të vijnë. Lufta në juglindje të Ukrainës, ka forcuar pozitat e kryengritësve pro-rusë që duan pavarësinë, më shumë sesa përçarjen që po i bën politikës ukrainase Kremlini. Ndërsa armatosja nga Kremlini e forcave separatiste, po rrezikon pasjen e një forcë të armatosur rëndë dhe të paparashikueshme në kufirin e vet.

Gjatë së ashtuquajturës përgjumje që pasoi 2 marrëveshjet e Minskut, ushtria ukrainase ka përforcuar pozitat e veta, kështu që nuk ka siguri se rebelët pro-rusë mund t'i mposhtin ata. Prandaj, Byroja Politike 2.0, duhet të pyesë veten: Cili është hapi tjetër i zotit Putin, dhe a mund të përballojmë të shkojmë sërish pas tij? Asnjë nga opsionet e Putinit nuk janë të mira. Nëse ai tërheq armët, trupat dhe mbështetjen për rebelët pro-rusë, Ukraina do të rimarrë Donbasin, dhe Putini e Byroja e tij Politike 2.0, do të jenë humbësit e etiketuar. Nëse ai nis një ofensivë të re kundër Mariupolit, ose për të fituar një rrip toke që ta lidhë me Krimenë, Perëndimi do të vendosë sanksione, të cilat do të shembin ekonominë që tashmë ndodhet në agoni, dhe do vënë kësisoj në rrezik pasuritë e anëtarëve të Byrosë Politike 2.0.

Sanksionet mund të përfshijnë opsionin “bërthamor” të dëbimit të Rusisë nga SWIFT-i, sistemi i transferimit bankar dhe bllokuar thuajse tërësisht transaksionet financiare ruse. Ata që përfituan nga kleptokracia e Putinit, do të përballen me rrënimin. Shumë vetë parashikojnë fundin eventual të regjimit të Putinit, por mbetet e paqartë sesi kjo mund të ndodhë.

Si një president i zgjedhur nominalisht, Putini do të duhet ose të japë dorëheqjen, ose të pushojë së ekzistuari. Treguesit sugjerojnë se procesi do të fillojë me një sulm ndaj bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Putinit, çka duket në rrugë e sipër. Së pari, sekretari për shtyp i Putinit, Dimitri Peshkov, u akuzua nga blogeri i opozitës Aleksei Navalni se kishte marrë me qera një jaht në Sicili, për 500.000 dollarë në javë. Mohimi i Peshkovit, u rrëzua nga fotot e publikuara në mediat sociale. Raportimet e skandaleve të Navalnit shpesh injorohen, por kjo histori vazhdoi në mediat kryesore ruse, duke përfshirë RBC, Pravda.ru dhe të tjerët. Peshkov është tashmë nën sulm nga gazeta “Vedemosti”, se mban në dorë një orë që kushton plot 620 mijë dollarë, me pagën e një nëpunësi civil.

Së dyti, njeriu i afërt i Putinit dhe objekt i sanksioneve perëndimore, Vladimir Jakunin, në vitin e parë të një kontrate 5-vjeçare, njoftoi dorëheqjen si kreu i monopolit hekurudhor rus, për t'u bërë një senator i krahinës së Kalingradit. Sipas një burimi për “Forbes Russia”, “nëse dorëheqja do të ndodhë realisht, kjo do të thotë se diçka shumë serioze ka ndodhur në ditët e fundit”.

Raportet e shtypit rus, vënë në dukje se Jakunin ka refuzuar të bëjë të ditur burimet e të ardhurave të tij, sepse një çështje nuk diskutohej në kompaninë e tij. Blogeri anti-korrupsion Navalni ka mbushur boshllëkun informative, me një inventar prej 14 faqesh të pronave të Jakunin, duke përfshirë edhe kështjellën e tij. Së treti, “i njohuri e tij prej një kohë të gjatë që nga fëmijëria, biznesmeni Genadi Timçenko” është subjekt i një investimi serioz nga gazeta “Vedemosti”. Artikulli raportonte se Timçenko “i izoluar nga bota perëndimore për shkak të sanksioneve”, nuk mund të vizitojë më vilën e tij në brigjet e liqenit të Gjenevës”, ndërsa është i detyruar të jetojë në rezidencën e ish-kreut të shtetit Nikita Hrushov. Artikulli i “Vedemosti”-it, përmend pastaj një listë të gjatë partnerësh hije në sipërmarrje, që bëjnë biznes jotransparent dhe tregti me kompanitë gjigande ruse si Rosneft, Surgutneft dhe Transneft me të cilat “s’mund të kesh kontakte, pa patur marrëdhënie të mira në nivelet më të larta”.

Kolosi i tregtisë së naftës “Gunvor”, gjysma në pronësi të Timçenkos para se të vendoseshin sanksionet janë, luan një rol periodik në shkrim. Në mënyrë të veçantë, pronësia klandestine e Putinit në “Gunvor”, është deklaruar të jetë burimi kryesor i tij i pasurisë së tij miliarda dollarëshe. Diskutime e hapurat mbi Timçenkon dhe “Gunvor” kanë qenë më parë të pamendueshme për shtypin kryesor rus.

Së katërti, ish-truproja personale e Putinit, dhe kreu i trupave të sigurisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Viktor Zolotov, ka qenë objekt i një sulmi nga ana e mediave të titulluar “Të gjithë plehrat nën një kolibe”, me publikimin e lidhje të forta me shërbimet e sigurisë.

Si në rastet e tjera, pronat e shumta të Zolotovit, apartamentet, dhe forma të tjera të pasurisë u shpalosën në detaje të dhimbshme. Artikulli përfundon me një akuzë ndaj shefit të tij, Vladimir Putin: "Nëse ish-truproja e Putinit, arriti të bëhet i pasur në shërbimin civil, me më shumë se 1 miliardë dollarë, çfarë mund të themi për atë që ishte duke ruajtur? Ky është rasti, kur heshtja është flori".

Disa analistë i shpjegojnë këto ngjarje si lodhje të Putinit nga miqve e tij, dhe dëshira për të rindërtuar parinë e tij. Një shpjegim i tillë, nuk ka gjasa të përkojë me të vërtetën. Me ekonominë në kolaps dhe një konflikt të ngrirë në Ukrainë, Putini ka nevojë për të gjithë miqtë e tij, sidomos ata që ndodhen nën akuzë për korrupsion, dhe që mund të dinë detaje nga korrupsioni i tij. Diktatorët nuk qëndrojnë në pushtet duke braktisur aleatët e tyre, veçanërisht në kohë të vështira.

Më së paku, një lloj lufte për pushtet po ndodh, dhe duket të ketë Putinin si objektiv. Modeli i sulmit është klasik: të rrëzojë në fillim mbështetësit djalit të madh. Ndonëse disa argumentojnë se çdo udhëheqje e re që mund të vijë nga Byroja Politike 2.0, do të jetë po aq e keq sa Putini, komentatori rus Andrej Pionovski mendon ndryshe. Ai pretendon se anëtarët e elitës ruse, kanë dërguar sinjale në Perëndim se "çdo gjë do të zgjidhet në javët e ardhshme".

Ne kemi pasur alarme të rreme edhe më përpara. Ky mund të jetë alarmi fals i rradhës, por të paktën tani mund të shohim një rrugë drejt fundit të regjimit të Putinit. Ne duhet të kemi parasysh, se Putini e kaloi në Krime përvjetorin e grushtit të shtetit të 19 gushtit 1991 kundër Mikail Gorbaçovit. Vlen gjithashtu vlen të përmendet, se ai mori me vete 4 anëtarë të rëndësishëm të qeverisë së tij, që ka të ngjarë të zgjedhin pasardhësin e tij. Mbani mend moton: Mbani miqtë tuaj pranë, dhe armiqtë tuaj edhe më afër.

"Forbes"



10 pika për një përgjigje evropiane ndaj problemit të emigracionit

NGA SIGMAR GABRIEL & FRANK-WALTER STEINMEIER

Evropa gjendet përballë një detyre, që do të peshojë mbi një gjeneratë të tërë: nuk ka patur kurrë më parë, kaq shumë njerëz që i ikin persekutimit politik dhe luftërave si sot. Shumë prej tyre kërkojnë mbrojtje këtu në Evropë. Ne duhet të qartësojmë idetë mbi zgjidhjen që duhet t'i japim këtij problemi, duke patur parasysh se për shkak të krizës në vendet fqinje me kontinentin tonë, situata nuk do të ndryshojë në vitet e ardhshme.

Ne evropianët, i detyrohemi vetes dhe botës një zgjidhje në lartësinë e sfidës, që përfaqësojnë këta njerëz në kërkim të ndihmës. Një gjë është e qartë: përgjigja e dhënë deri më tani, nuk është në lartësinë e pritshmërive, që Evropa duhet të ushqejë në raport me vetveten. Evropa s'mund të vazhdojë të hezitojë, Bashkimi Evropian duhet të veprojë tani.

Pikërisht për këtë arsye, ne duhet të ndjekim një politikë të përbashkët evropiane për të trajtuar azilkërkuesit, refugjatët dhe emigrantët, që të bazohet në parimin e solidaritetit dhe në vlerat tona të humanizmit që ne të gjithë ndajmë me njëri-tjetrin.

Po prezantojmë 10 pika kryesore:

1. Kudo emigrantët në BE, duhet të jenë të mirëpritur me dinjitet të barabartë njerëzor. Për këtë, ne kemi nevojë për standarde që të zbatohen në të gjithë unonin dhe ndiqen nga çdo shtet anëtar.
2. Nevojitet një kod ligjesh që të rregullojë çështjen e azilit politik dhe të garantojë për refugjatët, njohjen e statusit të tyre në të gjithë BE-në. Për të arritur këtë objektiv, në një periudhë afatgjatë, na duhet një projekt i ri integrimi të politikave të azilit, që të ketë një fushëveprim shumë më të gjerë, sesa ato të propozuara deri tani.
3. Duhet t'i rishpërndajmë në mënyrë të barabartë emigrantët në të gjithë Evropën. Asnjëherë më parë nuk janë angazhuar qytetet e vogla dhe qytetarët e tyre në pranimin dhe integrimin e refugjatëve në vendin tonë. Ky solidaritet do të vazhdojë edhe me kalimin e kohës, vetëm nëse të gjithë mund të shohin me sytë e tyre, se në Evropë ka drejtësi.
Një situatë në të cilën, siç ndodh tani, vetëm disa shtete anëtare duhet të menaxhojnë të gjithë fluksin e refugjatëve, është e paqëndrueshme, ashtu si një sistem që rëndon barrën e kësaj situatë në një mënyrë të paekuilibruar, vetëm tek vendet që rastësisht formojnë kufirin e Bashkimit Evropian. Ne kemi nevojë për kritere të detyrueshme dhe të mirëkuptueshme nga të gjithë, për një shpërndarje të fluksit të refugjatëve, në përputhje me aftësinë e shteteve për t'i menaxhuar ato.
4. Evropa ka nevojë për një menaxhim të përbashkët të kufijve. Megjithatë, s'mund të bëhet fjalë vetëm për mbrojtjen e kufijve. Përkundrazi, ne kemi ndërkaq nevojë për më shumë përgjegjësi të përbashkët në regjistrimin dhe dhënien e asistencës për emigrantët që vijnë.
5. Ne duhet që pa hezitim t'u shkojmë në ndihmë shteteve evropiane, që aktualisht po e vuajnë më tepër barrën e kësaj situatë. I vetmi shtet anëtar, që ka ofruar menjëherë ndihmë për të përmirësuar gjendjen e refugjatëve që hynë në Evropë nga ishujt grekë, ishte Gjermania.
Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare, duhet të veprojnë në këtë fushë në mënyrë më efikase, dhe të sigurojnë menjëherë mbështetje praktike dhe ekonomike vendeve që përballen të parët me fluksin e emigrantët. Sa i përket Gjermanisë, ne duhet të sigurohemi që komunitetet lokale mund t'ia dalin të përballojnë sfidat e pafundme që sjell kjo gjendje. Që kjo të ndodhë, ne duhet t'u garantojmë mbështetje financiare në mënyrë të qëndrueshme dhe sistematike.
6. Ne s'mund ta kufizohemi duke qenë vetëm spektatorë, ndaj rrezikut që përballojnë personat që përpiqen të vijnë tek ne. Mesdheu nuk mund të shndërrohet kurrësesi në një varr masiv për refugjatët të dëshpëruar. Në këtë rast, është në lojë trashëgimia e kulturës humanitare evropiane, madje vetë ideja jonë e përbashkët e humanizmit. Për këtë arsye, në pranverë u angazhuam në një përpjekje të përbashkët, përta i përket operacioneve të shpëtimit të emigrantëve në detin Mesdhe. Duhet ta përforcojmë këtë iniciativë, duke siguruar vazhdimin e operacioneve në një periudhë sa më afatgjatë, dhe siguruar ndërkohë mjetet e nevojshme.
7. Ne do të jemi në gjendje të ndihmojmë refugjatët në një periudhë afatgjatë, vetëm në rast se ata të cilët nuk i kanë kushtet e nevojshme për të aplikuar për azil politik, do të rrikthehen në vendet e tyre të origjinës. Për ta bërë këtë, ne duhet ta bëjmë politikën e ripranimin, një element qendror në marrëdhëniet tona me vendet nga vijnë këta emigrantët, dhe gjithashtu të jemi të përgatitur t'i ofrojmë këtyre vendeve një bashkëpunim konstruktiv për çështje të caktuara.
8. Duhet të biem dakord për të përcaktuar se cilat vende mund të konsiderohen vende të sigurta të origjinës. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, synojnë të jenë pjesë e BE-së. Për arsye të mira. Le t'u japim mundësinë atyre që të mund të bëhen anëtarë.
Kjo megjithatë do të thotë se ne ende s'mund t'i trajtojmë si të përndjekur, qytetarët e atyre vendeve. Në mënyrë ideale, një shtet që plotëson kriteret për t'u

konsideruar si një shtet kandidat për t'u anëtarësuar në union, gjithashtu duhet të konsiderohet një shtet i sigurtë i origjinës.

9. Gjermania ka nevojë për një ligj, që të disiplinojë emigracionin. Ne kemi nevojë për një politikë të zgjuar dhe kontrolluese ndaj emigracionit, e cila lejon marrjen e lejes së ligjshme të qëndrimit dhe punësimit në vendin tonë. Ne s'mund të vazhdojmë të rëndojmë sistemin tonë të azilit politik me këtë peshë.

10. Për të zbatuar politikën e pritjes së emigrantëve, ne kemi të gjithë nevojë të inkurajojmë iniciativa të reja politike, për të luftuar shkaqet që e shkaktojnë këtë fenomen nga Lindja e Mesme dhe Afrikë. Stabilizimi i situatës tek shtetet që janë shkatërruar, kufizimi i dhunës dhe luftërave civile, duhet të shkojnë dorë për dorë me përpjekjet specifike që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe krijimin e perspektivave reale ekonomike dhe sociale, në veçanti për qytetarët e rinj të atyre kombeve.

Të gjitha përpjekjet e komunitetit të shteteve, kryesisht të Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara, duhet të kenë këtë qëllim. E gjithë kjo tregon, se korniza në të cilën lëviz aksioni politik, nuk është më kombëtare, dhe mbi të gjitha përsa i përket politikave për pritjen e refugjatëve dhe emigrantëve.

Vetëm duke bashkëpunuar në nivel evropian, mund të mbërrijmë tek disa zgjidhje të ndjeshme. Për këtë arsye, politika e mikëpritjes është, fusha politike mbi të cilën ne duhet të ndjekim projektin e integritit evropian, me më shumë entuziazëm dhe bindje. Gjermania është e gatshme të çojë përpara projektin e një politike të përbashkët dhe solidarë të emigracionit, me të gjithë përkushtimin e nevojshëm.

Shënim: Sigmar Gabriel, Presidenti i Partisë Socialdemokrate Gjermane, Frank-Walter

Steinmeier, ministër i Jashtëm i Gjermanisë.

HuffPost



Kriza e imigrantëve po e ndan sërish Gjermaninë

The Washington Post

Qyteti i vogël gjermano-lindor i Heidenau përfundoi në faqet e para të gazeta-ve, pasi disa qindra mbështetës të Partisë Nacional Demokratike të ekstremit të djathtë, nën thirrjet “Heil Hitler” u përplasën me policinë javën e kaluar. Ishte një ngjarje e cila nxorri edhe një herë në pah ndarjen mes lindjes dhe perëndimit të Gjermanisë.

Dikur një qytet tipik industrial në Republikën Demokratike Gjermane (RDGJ) komuniste, ku uzinat falimentuan pas ribashkimit, Heidenau është shndërruar tashmë në një simbol të valës më të fundit të urrejtjes neonaziste, si dhe dhunës që po përhapet në Gjermani. Kancelarja Angela Merkel udhëtoi në Heidenau të mërkurën, për të dënuar dhunën dhe u prit me fërshëllima teksa dilte nga makina e saj. Një protestues mbante një pankartë ku lexohej “Tradhëtare!”, një fjalë që i drejtohej Kancelares. Të tjerët thërrisnin: “Ne jemi llumi!”, duke iu referuar fjalëve të zëvendëskancelarit, Sigmar gabriel, i cili i kishte quajtur “llum”, neonazistët e Heidenaut.

Protestat në Heidenau kanë qenë më të mëdhatë deri tani në Gjermani, teksa më shumë se 30 policë janë plagosur, por nuk janë të izoluara. Europa po përjeton prurjet më të mëdha të refugjatëve që nga Lufta e Dytë Botërore, dhe Gjërma-

nia pret më shumë prej tyre, se sa të gjithë fqinjët e saj. Qeveria ua bëri më të lehtë të ardhurve nga Siria, që të qëndrojnë në vend, si dhe premtoi ndihmë të mëtejshme financiare për shtetet dhe bashkitë që përballojnë fluksin e refugjatëve. Shumë vullnetarë në të gjithë vendin po ndihmojnë imigrantët. Por, ka edhe protesta dhe dhunë ksenofobe. Fondacioni Amadeu Antonio, që mbledh të dhëna mbi sulmet kundër refugjatëve dhe kampeve ku këta strehohen, numëroi 345 raste deri në 25 gusht, një rritje e madhe krahasuar me një vit më parë.

Grafiku tregon se janë incidente që nuk janë të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë vendin. Ndonëse ka shumë sulme me zjarrvënje në Gjermaninë perëndimore, sidomos në Bavari dhe në Rhine-Vestflainë Veriore, është lindja komuniste që ka më shumë incidente kundër refugjatëve. Shteti i Saksonisë, ku ndodhet Heidenau, ka numrin më të madh të sulmeve kundër vendstrehimeve të refugjatëve.

“Ne kemi numrin më të madh të rasteve të dhunës, ndër rajonet ku ekzistojnë tashmë struktura të të djathtës ekstreme”, shpjegon Robert Luedecke, zëdhënësi i Fondacionit Amadeu Antonio. “Problemi nuk janë qytetet, shumica e sulmeve ndodhin në fshatra”. Numri më i lartë i sulmeve kundër refugjatëve korrespondon me rritjen e pranueshmërisë për idetë ksenofobe në ish RDGJ. “Tendencat drejt të djathtës ekstreme janë më të forta në lindje”, thotë Luedecke. “Njerëzit ishin të çorientuar pas ribashkimit, u shfaq një boshllëk, dhe Partia Nacional Demokratike ishte aty, e gatshme për ta mbushur”.

Një studim i kryer që nga viti 2002 nga Universiteti i Laipcigut ka gjetur se ka më shumë mbështetje në lindje për Partinë Nacional Demokratike, si dhe shprehje të deklaratave ksenofobe, si “kur nuk ka vende pune të mjaftueshëm, ne duhet të kthejmë të huajt andej nga kanë ardhur”.

Elmar Braehler, një prej autorëve të studimit, thotë se ndarja lindje-perëndim është rezultat i një përzierje komplekse të niveleve të arsimit dhe punësimit, si dhe kontaktit me të huajt. “Ka patur një largim të trurit në Lindje, teksa njerëzit më të arsimuar u larguan, në kërkim të punës”, thotë ai. Ai sheh një lidhje me nivelin e arsimit dhe papunësisë. Sipas studimit, pranueshmëria për deklaratat ksenofobe pati rritje në lindje mes viteve 2002 dhe 2012, dhe nisi të bjerë në vitin 2014, me përmirësimin në punësim.

Mungesa e kontaktit me të huajt në RDGJ-në komuniste, ka qenë gjithashtu një faktor që ka kontribuar në sjelljen ndaj refugjatëve. Por edhe në Gjermaninë e sotme, shumica e të huajve jetojnë në Perëndim, teksa vetëm 10.5% e tyre jetojnë në Lindje. Sipas një harte të botuar në të përjavshmen gjermane Die Zeit, në numrin e qershorit, Saksonia ka përqindjen më të vogël të refugjatëve në raport me popullsinë, me një refugjat për çdo 238 banorë. Ndërkohë që në Bremen, ky raport është 1 me 56. Dhuna në Heidenau shkaktoi komente në median gjermane, në lidhje me një ndarje që vazhdon mes lindjes dhe perëndimit. “A ka kohë për Saxit?”, pyeste Stefan Schirmer, një komentator i të përjavshmes Die Zeit, duke iu referuar Grexit-it (daljen e debatuar të Greqisë nga euro), si dhe duke ngritur pyetjen, nëse shteti i Saksonisë dhe vlerat e tij të ekstremit të djathtë, i përka-sin ende Gjermanisë. “kemi nevojë për ndihmën tuaj në Saksoni”, shkruante një tjetër komentator. “Na duhet jo vetëm të integrojmë refugjatët në shoqërinë tonë, por edhe shumë prej banorëve të Saksonisë, në demokraci”.

Tabloidi Bild, në një koment në anglisht, kujtonte se si njerëzit nga ish RDGJ, shkuan drejt Gjermanisë Perëndimore në vitin 1989. “Urrejtja kundër refugjatëve sot, po ndodh pikërisht atje ku, pak vite më parë, të bëheshe refugjat ishte e vetmja shpresë që të kish mbetur. Ndonëse Heidenau është vetëm një pjesë e vogël e Gjermanisë, ai është shndërruar në një turp për vendin tonë”.

Përkthimi: Bota.al



Greqi, kostoja e zgjedhjeve të reja

YANNIS PALAIOLOGOS

Nuk ka mungesë cinizmi, komente sarkastike në mesin e grekëve – në Twitter apo në bisedat e tjera – për faktin se vendi po shkon në zgjedhjet për herë të tretë në tetë muaj. Ka një entuziazëm tallës, mbi të qenit vendi më demokratik në botë, shumë referenca për talentin e kryeministrit Aleksis Cipras “për t’u zgjedhur sesa për të qeverisur”, si dhe sugjerimet që data e kontestuar të jetë sërish një farë referendumi.

Në mes të gjithë kësaj, ka karakteristika të caktuara kryesore të zgjedhjeve të reja, që do të mbahet më shumë gjasa më 20 shtator, të cilat duhet të mbahen në mend. Së pari dhe më kryesorja, kreditet do të jenë shumë më të ulëta se në muajin janar.

Në atë kohë, sfidanti Cipras, u zotua të heqë dorë nga marrëveshja e shpëtimit të Greqisë, duke u premtuar votuesve grekë çdo gjë, nga bllokimi i privatizimeve deri tek fshirja e një pjesë të madhe të borxhit publik dhe anulimi i taksave jopopullore, duke parandaluar shkurtimin e mëtejshëm të pensioneve dhe dhënien e një nxitje të madhe për shpenzimet sociale.

Fitorja e tij, çoi në mënyrë të pashmangshme në një përballje dramatike me kreditorët e vendit, të cilat nga ana e tyre e çuan atë në prag të Grexit dhe përsëri

në recesion. Këtë herë, pasi ka thyer të gjitha ato premtime, Syriza e Cipras – apo çfarë ka mbetur prej saj pas largimit të fraksionit Platforma e Majtë pro-dhrahmisë – do të kandidojë, megjithëse pa qejf, si një parti pro-shpëtimit.

Kjo do të thotë, se asnjë nga palët me një shans të arsyeshëm për të fituar – Syriza dhe Demokracia e Re e qendrës së djathtë – nuk do të sfidojë statusin e marrëveshjes së re, duke çuar në një periudhë të re të rinegociimit dhe turbullirave të mëtejshme.

Reagimi pozitiv i kancelares gjermane Angela Merkel, ndaj zhvillimit të zgjedhjeve të reja – ajo i tha presidentes braziliene Dilma Rusef gjatë takimit të përbashkët, se vendimi është pjesë e zgjidhjes, jo e problemit – sugjeron se udhëheqësit evropianë kanë qenë në dijeni të këtij zhvillimi.

Ky është rasti, sepse Cipras, fituesi i mundshëm i zgjedhjeve, pasi u mberthyer nga asfiksioni financiar dhe kërcënimi i një dalje nga monedha e përbashkët, tani sheh dy karrota plot lëng të varura përpara tij: perspektivën e ndihmave të konsiderueshme të borxhit pas përfundimit të shqyrtimit të parë të programit të ri, dhe përfshirjen e obligacioneve të qeverisë greke në programin e Bankës Qëndrore Evropiane të Lehtësimit Sasior.

Kombinimi i tyre, do të çojë në një rënie të kostove të huamarrjes në vend, dhe në kohën e duhur mund të çojë atë në tregjet e kapitalit, si dhe rindezë interesin e investitorëve të huaj tek ekonomia reale e Greqisë.

Çmimi për të paguar

Natyrisht, e gjithë kjo do të varet nga zbatimi i reformave, një nga përbërësit thelbësorë që mungoi nga pala greke gjatë periudhës së shpëtimit – pjesërisht për shkak se kërkesat e programit ishin shumë të vështira, por edhe për shkak se politikanët grekë nuk ishin të gatshëm për t'i trajtuar marrëveshjet komode afagjata, si në sektorin privat, ashtu edhe atë publik.

Do të duhet ca kohë, për të zbuluar se si edhe qeveria e re do të veprojë në këtë front. Por në qoftë Cipras nuk arrin të fitojë një shumicë të plotë, zgjedhja e partnerit të tij në koalicion dhe krijimi i kabinetit të ri, do të zgjasë jo pak.

Deri më tani, ai ka qeverisur në aleancë me Greqët e Pavarur, me të cilët Syriza ka pak afërsi ideologjike – një grup populist i krahut të djathtë, *raison d'être* e të cilit kishte qenë opozita ndaj planeve të shpëtimit (dhe që u formua pikërisht për të kundërshtuar planin e dytë të shpëtimit në vitin 2012).

Zgjedhja këtë herë e një partneri pro-evropian të qendrës, do të jetë një tregues i fortë i qëllimit për të zbatuar programin për të cilin është rënë dakord. Sinjali do të jetë edhe më e qartë, nëse ai shmang hierarkinë e partisë së tij dhe deputetëve të zgjedhur, për të emëruar në portofolet kyçe, disa ekspertë të jashtëm të angazhuar për të rënë dakord mbi reformat.

Zgjedhja për të mbajtur zgjedhje të parakohshme, nuk është sigurisht pa kosto. Cipras mund të argumentojë se përçarja tek Syriza – pothuajse një e treta e deputetëve, të cilët refuzuan ta mbështesin atë në votimin e fundit për paketën e tretë të shpëtimit – ka forcuar pozitën e tij.

Por marrëveshja, u miratua me më shumë vota se dy të mëparshmet, falë mbështetjes së palëkundur të Demokracisë së Re dhe të dy partive të tjera pro-evropiane, Potami dhe PASOK. Ai mund të kishte lejuar rebelët e Platformës së Majtë, të formonin grupin e tyre parlamentar dhe të qeveriste me mbështetjen e opozitës pro-evropiane, për të siguruar zbatimin e qetë të programit të ri dhe përfitimet që do të vijnë me të.

Tani, ne përballemi me të paktën dy muaj pasiviteti, në aspektin e zbatimit të programit, duke pasur parasysh ritmin e ngadaltë me të cilën kanë punuar ministrat e rinj dhe që mund të fillojnë punën kuptimplotë në Greqi. Kjo do të thotë se negociatat mbi borxhin do të fillojnë më vonë, dhe pjesëmarrja e Greqisë në programin e lehtësisë sasiore do të vonohet.

Kjo ndërkaq mund të çojë në një përkeqësim të recesionit për këtë vit, dhe në një

rritje të mëtejshme të kostos së rikapitalizimit të bankave të Greqisë. Është një çmim i lartë për t'u paguar, edhe për zgjidhjen e përçarjeve të brendshme të partisë në pushtet – një zgjidhje që në fakt duhet të kishte ndodhur që para zgjedhjeve janarit.

Megjithatë, për këtë të fundit nuk mund të bëhet më asgjë. Ndoshta fryma e zgjedhësve do të spastrojë nga Syriza ata elementë, që do të preferonin një kthim tek dhrahmia përkundrejt paketës së re të shpëtimit që do ta bëjë vendin më të qeverishëm. Por sukcesi i programit të ri, do të varet në mënyrë vendimtare nga qasja e njeriut, që ndodhta ndoshta do të mbetet kryeministër pas zgjedhjeve. Duke njoftuar dorëheqjen e tij në 20 gusht, Cipras foli sërish për “shantazhe” dhe “ultimatume”, që ai i vuajti në duart e kreditorëve. Ai përsëriti disa herë se nuk beson në programin e ri. Vetëm kur mbrojti veten kundër Platformës së Majtë, ai theksoi disa elemente pozitive të marrëveshjes së arritur.

Kjo duhet të ndryshojë. Ai duhet të gjejë një mënyrë për të përqaftuar programin, dhe t'ia shesë atë një opinion publik grek që ende i jep atij përfitimin e dyshimit. Përndryshe zbatimi i saj, ka të ngjarë ta rrëzojë sërish, ndërsa tensionet me kreditorët do të rriten dhe ekonomia greke do të mbetet e ngërthyer në moçal.

Shënim: Yannis Palaiologos është gazetar i gazetës “Kathimerini” dhe autor i librit “Trembëdhjetë bëmat e Herkulit”



Drejt zhgënjimit të dytë

**NGA BULENT ALIRIZA
“CENTER FOR STRATEGIC AND INTERNATIONAL STUDIES”**

Zgjedhësit turq do t’u drejtohen sërish kutive të votimit, për herë të dytë në më pak se 5 muaj, kryesisht për shkak se presidenti Erdogan ishte i pakënaqur me rezultatet e zgjedhjeve të 7 qershorit, të cilat për herë të parë nga nëntori i vitit 2002, e privuan AKP-në nga fitimi i një shumice parlamentare.

Pasi u shfaq çuditërisht i qetë në publik për disa ditë me rradhë, pas atij që duhej të ishte një rezultat jashtëzakonisht zhgënjyes në zgjedhje, Erdogani shprehu dëshirën e tij që në 13 qershor për “përsëritjen sa më shpejt të zgjedhjeve”, duke shtuar se “në rast se nuk do të mund të formohet një qeveri koalicioni, shkuarja sërish në zgjedhje, në përputhje me kushtetutën është diçka e pashmangshme, ashtu sikurse është e pamendueshme për vendin që të mbetet pa qeveri”. Erdo-

gani ishte plotësisht i vetëdijshëm, për rreziqet që çdo lloj koalicioni do të paraqiste ndaj aftësive të tij për të qeverisur që nga presidenca si më parë, përmes një qeverie tërësisht të AKP-së, dhe me një kontroll të hekurt mbi një shumicë të bindur në parlament që garantonte besnikërinë e burokracisë dhe parandalimin e një rifillimit të hetimeve mbi korrupsionin, që synojnë rrethin e tij të ngushtë. Prandaj, ai efektivisht e bllokoi formimin e një qeverie koalicioni, duke përdorur kontrollin e tij të hekurt mbi AKP-në, ndonëse formalisht e lejoi kryeministrin Davutoglu të shkonte në negociata me partitë e tjera parlamentare, teksa skadonte afati kushtetues. Është plotësisht e kuptueshme, që Erdogan dhe AKP-ja e kanë patur të vështirë për të kryer rregullimin e nevojshëm psikologjik për ndarjen e pushtetit, pas dominimit të tyre të gjatë në politikën turke, duke preferuar më tepër skenarin e ripërsëritjes së zgjedhjeve, në përpjekje për të rifituar një shumicë parlamentare.

Vendimi i tyre për të shkuar në zgjedhje të reja, duket të jetë pjekur me argumentin se “hedhja e zareve” siç është përshkruar ky akt, nuk është shumë e rrezikshme, për shkak se AKP-ja është pothuajse e sigurtë se do të dalë nga zgjedhjet e ardhshme si partia kryesore.

Rrjedhimisht, edhe nëse nuk arrin sërish të fitojë një shumicë të thjeshtë, ajo do të ruajë rolin e saj udhëheqës në negociatat pas zgjedhjeve, për krijimin e një qeverie të re. Erdogan e rishprehu hapur ambicjen e tij për ndryshimet kushtetuese, kur dy javë më parë deklaroi në media se për shkak të zgjedhjes së tij si president drejtpërdrejt nga populli vitin e shkuar, “sistemi politik në Turqi kishte ndryshuar, u pëlqen apo jo disave”.

Duke argumentuar vazhdimisht se sistemi parlamentar aktual, është në grahmat e fundit, Erdogan shpreson që rezultati i zgjedhjeve të 1 nëntorit t’i mundësojë ndërmarrjen e ndryshimeve kushtetuese, për të forcuar pushtetin e tij. Duke vazhduar të drejtojë vendin pas 7 qershorit, Erdogani ka përfituar nga pasiguria politike pas- zgjedhore, për të konsoliduar rolin e tij kryesor në politikëbërje. Nën drejtimin e tij kryesisht të fshehtë, por herë pas here edhe të hapur, vendimet me ndërlikime të mëdha dhe emërimet e mëdha burokratike, vazhduan të merren teksa ndërsa presioni mbi lëvizjen Gylen, mediat kritike si dhe komunitetin të biznesit, nuk ka patur asnjë pushim, as për shkak të zgjedhjeve.

Lëvizja më e rëndësishme e Erdoganit gjatë kësaj periudhe, ishte konfirmimi i përfundimit të procesit të paqes kurde, që ai vetë e kishte iniciuar, dhe rifillimi i veprimeve ushtarake kundër PKK në juglindje të vendit, si dhe në veri të Irakut. Në mënyrë domethënëse, sulmet e vazhdueshme ajrore ndaj bazave të PKK-së përtej kufirit turko-iraken filluan në 24 korrik, dy ditë pasi Erdogan kishte përfunduar personalisht një marrëveshje, gjatë një bisede telefonike me presidentin amerikan Barak Obama, për ta lejuar më në fund SHBA-në të përdorë bazën ajrore të Inçirlikut për sulmet ndaj ISIS-it në Siri, dhe shpalljen e koordinuar se Turqia po hyn në një politikë përbaljeje me kërcënimin e dyfishtë terrorist nga ISIS-i dhe PKK-ja.

Ky veprim i diskutueshëm, jo vetëm që thekson statusin e tij si një udhëheqës i fortë dhe me kontroll të plotë mbi politikën e jashtme dhe të sigurisë kombëtare, por edhe përgatit terrenin për një fushatë zgjedhore që do të rrezikojë pozitën partisë kurde HDP, përmes lidhjes së saj me PKK, ndërsa apelon ndaj votuesve nacionalistë të cilët mbështetën Partinë Veprimi Kombëtar (MHP), dhe rifituar besnikërinë e të lëkundurve ndaj AKP-së. Duke parë nga e ardhmja

Sikurse është shprehur dikur ish-kryeministri britanik Harold Wilson, një javë është një kohë e gjatë në politikë. Dhe ka shumë javë përpara zgjedhjeve të reja turke. Megjithatë, ndërsa është e vështirë të parashikohet me saktësi se çfarë do të ndodhë në 1 nëntor, mbetet gjithësesi e sigurtë të thuhet se rruga drejt rimarrjes së dëshiruar të rezultateve të zgjedhjeve të fundit, nuk ka gjasa të jetë diçka e lehtë për AKP-në.

Në fakt, me sondazhet që sugjerojnë se ka gjasa të ndodhë një ndryshim i rëndësishëm në preferencat e zgjedhësve, ekziston rreziku real i një zhgënjimi të dytë të njëpasnjëshëm elektoral për AKP dhe Erdoganin, që u përfshi me entuziazëm në fushatën zgjedhore të qershorit, dhe me siguri po kështu do veprojë prapë, pavarësisht nëse kjo ndihmon apo jo AKP-në, me të gjithë pasojat e saj për perspektivat e tyre të ardhshme politike.

Qëllimi kryesor strategjik i AKP-së në fushatën e kaluar, ishte të përpiquej të mbante HDP nën pragun zgjedhor kombëtar prtej 10 përqind, duke e sulmuar këtë të fundit për lidhjet e saj me PKK-në, me qëllim sigurimin e një shumice të qartë në parlament, përmes fitimit të të gjitha zonave në juglindjen e Turqisë e banuar në shumicë kurde. Fushata e ardhshme do të shohë AKP, të përdorë retorikën e saj të drejtpërdrejtë luftarake ndaj HDP-së së Selahatin Demirtas, paralelisht me intensifikimin e konfliktit me PKK-në si në Turqi, ashtu edhe përtej kufirit turko-iraken. Megjithatë, sikurse e tregoi rezultati i zgjedhjeve në 7 Qershor, HDP ka rrudhur ndjeshëm

mbështetjen që më parë i jepej AKP-së në krahinat kryesisht kurde, duke fituar shumicën e zonave në juglindje.

Duket e pamundur, që AKP-ja të jetë në gjendje t'i rrëmbejë HDP shumë vota, çka do të thotë se kjo force politike duket se do e tejkalojë sërish dhe me lehtësi pragun elektoral prej 10 përqind, për shkak të konsolidimit të polarizimit etnik gjatë fushatës së tanishme kundër PKK. Për rrjedhojë, shpresa e AKP-së nuk është aq shumë që të marrë sërish votat e konservatore kurdë që e futën në parlament HDP-në, por të rifitojë mbështetjen e 3-4 përqind të votuesve konservatorë nacionalistë, të cilët në 7 Qershor e tradhtuan AKP dhe hodhën votën për Partinë e Veprimt Kombëtar (MHP).

Fakti që Davutoglu u ndje i detyruar t'i bëjë në mënyrë të përsëritur apel Partisë Popullore Republikane dhe asaj të Veprimt Kombëtar, për t'iu bashkuar qeverisë e përkohshme, dhe më pas për t'iu ofruar portofole ministrore në kabinetin qevritar individëve të shquar nga të dyja partitë, pavarësisht kundërshtimit të nga të dyja palët, dëshmoi shkallën e nervozizmit që ekziston në gjirin e AKP-së, lidhur me dëmin e mundshëm që mund të kishte nëse ajo, nëse në të njëjtën qeveri të përkohshme do të bënte pjesë edhe HDP-ja, çka do të ishte temë kryesore në fushatën e saj zgjedhore. Ekonomia ka gjithashtu të ngjarë të jetë një faktor i rrezikshëm për AKP-në në 1 nëntor. Duke ardhur në pushtet në nëntor të vitit 2002, si pasojë e një krize të madhe ekonomike, e cila kishte diskredituar tërësisht rivalët e tij politikë, AKP asokohe e konsolidoi dominimin e saj në politikën turke, nëpërmjet kultivimit të kujdesshëm të imazhit të saj, si garante e zhvillimit ekonomik dhe prosperitetit.

Ndërsa është e pamundur të llogaritet përqindja e atyre që braktisën AKP-në gjatë zgjedhjeve të fundit, për shkak të problemeve ekonomike, duket e arsyeshme të supozojmë se këto të fundit, nuk ishte një faktor i papërfillshëm në dështimin e AKP për të ruajtur shumicën e saj parlamentare në Asamblenë Kombëtare. Përkeqësimi i treguesve ekonomikë, i ilustruar nga zhvlerësimi i fortë i lirës turke, me pasojat e saj të rrezikshme për një ekonomi e cila është bërë shumë e ndërvarur nga fluksi i vazhdueshëm i fondeve të huaja, kreditë e buta dhe konsumi i brendshëm, së bashku me rritjen e perceptimit se gjërat mund të shkojnë edhe më keq, dhe mund të dëmtojnë edhe më shumë elektoralisht AKP-në në zgjedhjet e ardhshme.

Ndërsa është e pamundur të llogaritet përqindja e atyre që braktisën AKP-në gjatë zgjedhjeve të fundit, për shkak të problemeve ekonomike, duket e arsyeshme të supozojmë se këto të fundit, nuk ishte një faktor i papërfillshëm në dështimin e AKP për të ruajtur shumicën e saj parlamentare në Asamblenë Kombëtare. Përkeqësimi i treguesve ekonomikë, i ilustruar nga zhvlerësimi i fortë i lirës turke, me pasojat e saj të rrezikshme për një ekonomi e cila është bërë shumë e ndërvarur nga fluksi i vazhdueshëm i fondeve të huaja, kreditë e buta dhe konsumi i brendshëm, së bashku me rritjen e perceptimit se gjërat mund të shkojnë edhe më keq, dhe mund të dëmtojnë edhe më shumë elektoralisht AKP-në në zgjedhjet e ardhshme.

Nëse do të kishte qenë e gatshme për të formuar një koalicion me CHP, AKP-ja do të ishte në gjendje të ndante përgjegjësinë për problemet ekonomike. Në vend të kësaj, republikanët duken të gatshme të përfitojnë nga rënia ekonomike, së bashku me perceptimin e gjerë ndaj saj si një parti e cila është shumë më e etur për të formuar një koalicion dhe trajtuar problemet e vendit, sesa AKP-ja.

Së fundmi, në balancë duhet të vihet edhe ndikimi i mundshëm i luftës së tanishme kundër terrorizmit. Përyshim, Erdogan shpreson që të fitojë kapital politik mbi imazhin e tij si një udhëheqës i fortë, në kohën e një pasigurie të madhe politike dhe konflikti të armatosur.

Megjithatë, bombardimet e përditshme, përleshjet me armë dhe funeralet, që zgjedhësve u rikujtojnë kaosin para ardhjes së AKP-së në pushtet, sabotojnë në mënyrë të qëndrueshme mesazhin e saj të parë të suksesshëm të stabilitetit dhe prosperitetit. Një komplikim shtesë në këtë kontekst, është aleanca e re e Erdoganit me ushtrinë kundër PKK-së, ashtu si edhe lëvizjes Gülen, çka është në kontrast të thellë me politikën e tij të mëparshme, që synonte reduktimin e rolit të shquar dhe të dukshëm të ushtrisë në punët e vendit, në dekadat para se AKP të vinte në pushtet.

Marrë me shkurtime

- Shënim: Bulent Aliriza është drejtor i degës turke të Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington.
- Bota.al



Revolucioni i ri kinez, që po bën të dridhet ekonominë botërore

Pekini ka nevojë për më pak ngurtësi dhe më shumë decentralizim, por edhe BE duhet të reagojë në mënyrë fleksibël dhe dinamike, për të shmangur katastrofën

Nga Mariana Mazzucato
Profesore e Ekonomisë së Inovacionit, në Universitetin e Sussexit

Duhet të shqetësohemi vërtetë për atë që po ndodh në Kinë? Ngadalësimi i kohëve të fundit dhe zhvillimet më të fundit të normave të këmbimit janë vetëm “gurgullima” të vogla, apo duhet menduar vërtetë se rritja - për të gjithë theme-lore - e më të rëndësishmes prej ‘ekonomive në zhvillim’, ka përfunduar tashmë - me pasoja të rrezikshme globale? Gjithë sekreti është të qartësohesh për shkaqet. Por duket se analizat e llojit tradicional janë duke gabuar objektivin: ngatërrojnë shkaqete problemit, me simptomat.

Në një moment të vështirë për ekonominë botërore, e cila ende gulçon prej krizës financiare, me nivelet e ulët të kërkesës agregate prej uljes së investimeve dhe

shpenzimeve në shumë vende, ngecjen e eksporteve në vende si Kina (apo edhe Gjermania), kjo që po ndodh nuk mund të na habisë.

Rënia globale e çmimeve të lëndëve të para ka shkaktuar atë deflacion, që e shtyu Pekinin të reagojë me zhvlerësimin e juanit. Dhe raporti kinez mes borxhit dhe GDP-së është mburrur jo për shkak të një rritjeje të numëruesit, por për shkak të rënies së vlerës së emëruesit - pra rënies së çmimeve.

Në fakt, sot vëmendja përqëndrohet mbi të gjitha në zhvlerësimin e valutës kineze. Por bëhet fjalë për një reagim të thjeshtë të tregut, ndaj një mbivlerësimi të mëhershëm të saj (interpretimi më optimist), apo për një vendim strategjik të Kinës, për t'i dhënë shtysë eksporteve, në një situatë ekonomike deflacioni dhe rënieje të kërkesës? Sigurisht, hipoteza e dytë do të ishte më shqetësuesja. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të ekzaminojmë pikësepër disa faktorë themelorë. Norma zyrtare e rritjes ekonomike të Kinës në gjysmën e parë të vitit 2015, që ishte 7 %, e ka arritur objektivin e qeverisë. Deri këtu, nuk kishte asnjë arsye për shqetësim serioz. Por pyetja e vërtetë ishte, se prej ku buronte rritja ekonomike e mëhershme e Kinës. Në vitet e fundit, rritja ekonomike kineze nuk "shtyhej" prej eksporteve, por prej investimeve, të cilët kanë qenë shkak për më shumë se gjysmën e rritjes ekonomike vit pas viti, në periudhën 2004-2014. Tani, në tremujorin e parë të vitit 2015, rritja e investimeve në asete fikse ka qenë më e ulëta e regjistruar në Kinë, nga viti 2000 e deri më sot.

Motivi duhet kërkuar mbi të gjitha në përqëndrimin e investimeve në pasuritë e paluajtshme, kjo për shkak të një teprie të ofertës, teksa një numër i madh apartamentesh kanë mbetur të pashitur. Një rënie e tillë e redukton kërkesën për materiale ndërtimi, që nga ana e saj përcakton teprica të kapaciteteve prodhues, edhe në sektorë të ndryshëm nga ai i pasurive të paluajtshme. Kështu që, duhet të shqetësohemi jo prej të dhënave negative të eksporteve (që monopolizojnë vëmendjen e mediave), por prej atyre të investimeve.

Cila duhet të jetë përgjigja e Pekinit? Të vërë në zbatim një paketë stimuluesh, përmes shpenzimeve publike dhe investimeve, sipas shembullit që po përvijohet në disa vende europiane, për t'i dhënë një shtysë të fortë ekonomive të tyre apatike? Apo të vërë në zbatim një seri "reformash strukturore". Dhe nëse, siç po duket, orientimi i kinezëve do të ishte ky i fundit, për çfarë lloj reformash do të bëhej fjalë? jo atyre, të diskutueshme të BE, të përqëndruara në "ngurtësinë e tregut të punës" dhe shkurtime të kostove të pagave në sektorin publik, por reforma që rrisojnë një ribërje të sektorëve të tërë të ekonomisë: pra, një "ndryshim i vërtetë strukturor", në kuptimin e asaj që ka propozuar Luigi Pasinetti, ekonomisti më i rëndësishëm italian i dekadave të fundit - i cili sot mungon në debatin brenda BE - sipas të cilit, prioriteti nuk u duhet dhënë industrive tradicionale (me tepriç kapacitetesh prodhues), por konsumit dhe shërbimeve - me një rritje të investimeve në fusha të tilla, si turizmi, shëndeti, arsimit dhe Teknologjia e Informacionit.

Nuk mund të përjashtohet që në terma kohëshkurtër, një zgjedhje në këtë drejtim do të sillte një rënie të rritjes ekonomike, pikërisht për shkak se forca kryesore shtytëse e saj, ka qenë gjithmonë sektori i ndërtimit dhe investimet në industritë më tradicionale; por në terma kohëgjatë, kjo do të kontribuonte në riekulibrimin e ekonomisë dhe bërjen e saj më dinamike, duke mundësuar në zbatimin, në sektorë të ndryshëm të shërbimeve, ato risi që deri më tani janë përshtatur në dobi të industrive tradicionale.


Një tjetër aspekt i lënë në hije prej analizës tradicionale është ai i investimeve të mëdha kineze, në një fushë që, me shumë gjasa do të jetë ajo e revolucionit të ardhshëm të madh, pas Internetit: revolucionin e gjelbër. Plani i fundit 5-vjeçar parashikon një shpenzim prej 1.7 trilionë dollarësh në pesë sektorë të rinj, që përfshijnë energjitë e rinovueshme, teknologjitë e pajtueshme ekologjike dhe një brez të ri të Teknologjisë së Informacionit. Një orientim ky, i cili sigurisht që i

përgjigjet nevojës për t'iu kundërvënë niveleve shumë të lartë të ndotjes në qytetet kineze, por që lind edhe prej një vizioni të ri, të ngjashëm me atë të "Kthesës Energjetike" të Gjermanisë, e cila nuk ndalet tek energjitë e rinovueshme, por parashikon një riorientim total të ekonomisë në kuptimin ekologjik, për sistemet prodhues dhe për stilin e jetesës.

Kina është në vendet e parë mes investitorëve në fushën e energjive të rinovueshme, jashtë kufijve të saj - mbi të gjitha përmes Bankës Kineze të Zhvillimit. Ndërkohë që në Perëndim financa private vazhdon të privilegjojë investimet e lidhur me hiper-financiarizimin, është sistemi bankar kinez që financon ekonominë reale në shumë vende, edhe në fushën e infrastrukturave, si për shembull në Mbretërinë e Bashkuar. Kështu, ndërkohë që nga njëra anë Kina redukton investimet brenda saj dhe e zhvendos vëmendjen drejt shërbimeve dhe konsumit, jashtë vendit, ajo vazhdon të çojë përpara një strategji të bazuar mbi investimet, jo vetëm në zona me mangësi në zhvillim si Afrika, por edhe në vende europiane të kushtëzuar prej hiper-financiarizimit: Kina sot investon në infrastruktura angleze, ndërkohë që bankat angleze spekulojnë në operacione financiare. Natyrisht, këta investime kineze sjellin fitime që mund të përdoren për të financuar sektorë prioritarë.

Këto konsiderata ngrejnë disa pyetje, të ndryshme nga ato që janë bërë deri më sot në qendër të analizës tradicionale. Pyetja e parë ka të bëjë me ndryshimet e brendshëm, tjetra me ata të jashtëm. Në planin e brendshëm, është thelbësore të kuptojmë nëse hapja drejt tregut të lirë, do të shoqërohet me një hapje në rrafshin demokratik: një faktor kyç për rritjen "gjithëpërfshirëse". Do të kishte rëndësi të madhe, të dinim nëse theksi më i madh që Kina do u vinte konsumit dhe shërbimeve, do të ishte në inovacion, siç ka bërë kohët e fundit me industrinë tradicionale, si telekomunikacioni dhe energjitë e rinovueshme. Kompani si "huaëei", në vendin e parë në botë në fushën e telekomunikacionit, apo "Yingli Solar", një prej kompanive më të mëdha kineze në fushën e energjive të rinovueshme, janë rezultat i një investimi të duruar dhe kohëgjatë të kapitalit. Banka Kineze e Zhvillimit ka mbështetur kompanitë më inovative të këtyre sektorëve kyçë, me hua në rendin e miliardave. Kjo poletikë, e mbështetur nga një rritje eksponenciale e shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim, si dhe një shtytje e fortë ndaj kërkesës për teknologji të reja, përmes planit 5-vjeçar, i ka mundësuar vendit aziatik, që të hyjë në grupin e vendeve më inovatorë. Nëse tani do ta zhvendosë bariqendrën e vet drejt shërbimeve, do të ishte thelbësore që zhvillimi i tyre të çohet përpara në dritën e këtij vizioni. Nëse ia del, Kina do të vazhdojë, edhe në të ardhmen, që të afirmohet mes vendeve më inovatore.

Pyetja e dytë, është nëse Pekini parashikon të transformojë institucionet dhe organizatat e veta, për të bërë më fleksibël dhe të decentralizuara, me aftësi më të mëdha përshtatjeje ndaj ndryshimit të rrethanave, si në nivel kombëtar, edhe në nivel ndërkombëtar. Për t'i hapur rrugë inovacionit, Kina duhet të kapërcejë ngurtësinë e një sistemi të frymëzuar nga Bashkimi Sovjetik. Sot, investimet kineze, në pjesën më të madhe të tyre "bien" nga lart, përmes një organizmi të fuqishëm si Banka Kineze e Zhvillimit; në fakt do të nevojitej një sistem dinamik dhe i decentralizuar, me kontributin e agjencive të ndryshme, në shembullin e asaj që bëri Japonia në vitet 1980. Natyrisht, problemi parësor është ai i një veprimi të bashkërenduar në nivel botëror. Nëse në një vend si Brazili, kriza politike degjeneron në krizë ekonomike, apo nëse Eurozona vazhdon të përsërisë të njëjtin avaz, duke i imponuar masa shtrënguese njërit shtet pas tjetrit, me pasojë gruposjen gjithnjë e më shumë të rritjes ekonomike, edhe problemet e Kinës rrezikojnë të përkeqësohen. Dhe në këtë pikë, duhet të sjellim vëmendjen tek paaftësia jonë për të reaguar në mënyrë fleksibël dhe dinamike, në brendësi të BE-së, ndaj krizës që vazhdon të na shtypë: një tragjedi ekonomike dhe politike, me përmasa epike.



FRONTI I ARTE I kujt është Poli i Veriut?

Teorikisht, nuk i përket asnjë shteti të vetëm. Por ka vende që nuk bien dakord me këtë. Ata nuk duan akullin, por atë që ndodhet brenda shtratit të oqeanit: shumë depozita naftë dhe gazi

Supozoni që shponi një vrimë në shtresën e akullit në pikën më veriore të Tokës: Polin Verior gjeografik. Më pas ulni një kamera, të lidhur pas një kabli. Cfarë do të mund të regjistronte kamera?

Në metrat e parë, ka vetëm akull. Më pas, kamera zhytet në ujë, mbi të cilin lundron shtresa e trashë e akullit të Polin të Veriut. Kamera ulet ngadalë në ujërat shumë të ftohtë të Oqeanit Arktik. Nuk shihen shumë bimë detare. Shumica e peshqve që jetojnë këtu, e gjejnë ushqimin në shtratin e detit. Por ka ende shumë distancë për të përshkuar, deri atje.

Kamera arrin në fund të detit, vetëm pasi ka përshkuar një distancë prej 4 km, mu poshtë Polin të Veriut. A mund të shohim ndonjë gjë? Kamera “hedh një sy” rreth e rrotull. Pastaj, krejt papritur shfaqet diçka, që ti nuk e pret. Është një flamur, i ngulur në fund të detit. Flamuri është bërë me titan, i cili i reziston ndryshkut. Është një flamur trengjyrësh: e bardhë, blu, e kuqe. Flamuri i Rusisë.

Në Rusi u festua pothuajse si festë kombëtare, në vitin 2007, momenti i nguljes së këtij flamuri. Dy nëndetëse ruse, në bordin e të cilave kishte studiues, kishin zbritur në fundin e Oqeanit Arktik për të mbledhur mostra. Ishte një ngjarje e shënuar, por pas kthimit të tyre, të gjithë në Perëndim folën vetëm për flamurin që kishin vendosur studiuesit. Cfarë mesazhi po i dërgonte Rusia pjesës tjetër të botës? A po pretendonin se Poli i Veriut ishte i tyri? Dhe a mund ta ngrinin këtë pretendim, duke ngulur një flamur?

Vetëm flamuri nuk mjafton

Për t'iu përgjigjur menjëherë pyetjes së fundit: jo, nuk mund të pretendosh një copë tokë, thjeshtë duke ngulur një flamur mbi të. Ky nuk ishte as qëllimi i astronautëve amerikanë, që vendosën flamurin e tyre në Hënë. Është thjeshtë zakon të lësh një flamur pas, kur je i pari që shkel një destinacion të caktuar. Dhe kështu duhet të shihet flamuri rus në fundin e Oqeanit Arktik, shpjeguan rusët.

Por gjithësesi, ka një dallim. Amerikanët nuk pretenduan asnjëherë se donin të zotëronin Hënë. Nga ana tjetër, Rusia ka pretenduar se i takojnë pjesë të mëdha të zonës së Polit të Veriut. Dhe Rusia nuk është i vetmi vend që e thotë këtë. Danimarka (përmes Groenlandës), Kanadaja, Norvegjia dhe SHBA pretendojnë gjithashtu pjesë të mëdha. Asnjë prej tyre nuk është vërtetë e interesuar në akullnajat e pafundme mbi sipërfaqe. Ato duan atë që gjendet poshtë shtratit të oqeanit: rezervat e mëdha të naftës dhe gazit.

Fundi bëhet më i arritshëm

Arktiku, sa kohë që ndodhet jashtë ujërave territorialë të vendeve që e rrethojnë, nuk i përket asnjë shteti. As edhe Poli Verior gjeografik. Cdokush lejohet të shkojë atje, ashtu sikurse çdokush është i lirë të lundrojë në det të hapur, apo të shkojë në Hënë. Asnjë shtet nuk ka më shumë të drejta se të tjerët. Gjithësesi, një betejë po ndodh për Polin e Veriut. Kjo është nxehur në vitet e fundit, për shkak se akulli po shkrin prej ngrohjes globale. Kjo gjë e bën më të lehtë arritjen e shtratit të oqeanit, dhe rrugët detare për anijet po hapen më shpesh, prej shkrirjes së akujve. Vendet e përfshirë e patrollojnë rajonin me avionë dhe anije ushtarake, për të treguar se e kanë seriozisht pretendimin e tyre.

Ky mal është yni!

Fatmirësisht, asnjë e shtënë nuk është dëgjuar deri tani në betejën për Polin e Veriut. Për momentin, janë kryesisht avoketërit dhe diplomatët që udhëheqin luftimet. Zyrtarisht, Poli i Veriut nuk i përket askujt, por ka disa rregulla që gjejnë zbatim. Një rregull është se çdo shtet kufitar me Polin e Veriut (ashtu si gjithë shtetet që kanë vijë bregdetare), ka zonën e vet ekskluzive ekonomike. Kjo shtrihet deri 370 kilometra përtej vijës së tij bregdetare. Këtu, një shtet mund të gërmojë për minerale, mund të peshkojë dhe kryejë kërkime shkencore. Dhe kjo vlen edhe për zonat ekonomike të “vendeve të Polit të Veriut”. Megjithatë, problemi qëndron në faktin që ata të gjithë duan një zonë më të madhe për veten.

Një vend mund të pretendojë një copë më të madhe të shtratit të oqeanit për veten e tij, atëherë kur mund të vërtetojë se ajo copë i përket masës tokësore nënujore të tij. Kjo “pjesë kontinentale” është një pllajë brenda detit, e cila është pjesë e kontinentit dhe është në mënyrë të konsiderueshme më e lartë se sa shtrati i oqeanit që e rrethon. Një vend që mund të vërtetojë se ka më shumë pjesë kontinentale nënujore, mund të pretendojë gjithashtu një zonë më të madhe ekonomike.

Në rastin e Polit të Veriut, disa shtete përpiqen të vërtetojnë se janë “pronarë” të maleve që ndodhen në fund të Oqeanit Arktik. Është kurrizi malor Lomonosov, që shtrihet nga Siberia deri në Groenlandë, dhe përrshkon zonën e Polit të Veriut. Si Rusia, edhe Danimarka pretendojnë se kurrizi 1800 km i gjatë është i tyri.

Duke marrë mostra të shtratit, ata duhet të vërtetojnë se kurrizi malor i përket kontinentit të tyre nga pikëpamja gjeologjike, dhe të vendet shpresojnë të kenë të drejtë. Prej këtu buroi edhe misioni i nëndetëseve ruse në vitin 2007.

OKB shqyrton pretendimet

Janë Kombet e Bashkuara që vendosin nëse një shtet ka të drejtë për pretendimet e tij. Ato kanë hartuar traktate me rregulla në lidhje me menaxhimin e oqeanëve. Një komitet special i OKB këqyr pretendimet e shteteve, në lidhje me përmasën e pjesës kontinentale. Duhet vite përpara se të merret një vendim, sepse kërkimet gjeologjike në shtratin e oqeanit janë shumë të kushtueshëm dhe kërkojnë kohë. Gjithashtu, nëse ka një raport shkencor specifik, secili shtet duhet të shpjegojë që zbulimet janë në avantazh të tij. Ka edhe një tjetër mungesë avatnazhi: vendimi i OKB nuk është detyrues. Sido që të shkojë, vendet e përfshirë do të duhet të gjejnë zgjedhjet e tyre.

Me shumë gjasa do të jenë politikanët që do të ndajnë thesaret në fundin e Oqeanit Arktik. Nuk është problem nëse merren vesh, por për momentin, pretendimet e Ruisë nuk po shihen me sy të mirë nga të tjerët. Dhe e anasjellta. Cfarë do të ndodhte nëse Rusia thjeshtë do të fillonte shpimet për naftës, dhe nuk do të pyes-te fare se çfarë do të thoshin të tjerët? Askush nuk e di.

Stimul i madh

Gjithashtu, Poli i Veriut nuk është se do të mbushet em pajisje për nxjerrje nafte, sapo OKB të hapë dritën jeshile. Drejtori i një kompanie suedeze nafte shpjegoi vitin që kaloi, se do të duhen afro 15 vite përpara se të nisë prodhimi i naftës në Arktik. Kompanitë e naftës nuk janë shumë të nxitura për investime të reja, për shkak të të ardhurave të ulëta nga shpimet për naftë. Është shumë e kushtueshme, sepse njerëzit dhe makineritë do të duhet të mbrohen nga stuhitë e të ftohtit. Gjithashtu, zona është praktikisht e pazhvilluar. Portet janë shumë larg. Kalimi me anije duhet bërë patjetër në seri, me një akullthyerës në krye. Dhe ka probleme të sigurisë. Mendoni ajsbergët lundruer në zonë: duhet të sigurohesh që nuk do të krijojnë probleme. Po kështu, ka protesta nga organizata mjedisore si Greenpeace, që janë kundër shpimeve për naftë në Arktik, për shkak se do të dëmtohet ekosistemi.

Jo, nuk do të jetë e thjeshtë. Por stimuli është shumë i madh: 13% e rezervave ende të pazbuluara të naftës dhe pothuajse një e treta e rezervave të gazit ndodhen në zonën e Polit të Veriut. Kjo është arsye e mjaftueshme për të kërkuar pronësinë e rajonit.

Braintainment – Bota.al

Të fundit në bota.al 10 shprehje të Nikola Teslës, që kanë ende vlerë edhe sot



KULTURE

“Darka e Fundit” e Leonardos, e çkoduar

ME TEPER



HISTORI

Lindje komuniste, apo Perëndim? 1948-a: Viti që vendosi të ardhmen e Italisë



EKONOMI

Kriza e eurozonës dëshmon se s'kemi mësuar asgjë nga e shkuara



BOTA

Saga e pafund e reformave në Ukrainë



HISTORI

“Përse të mos jem edhe unë një tullë?” Shënime nga Ditari i shokut Lei Fen

SPECIALE



SPECIALE

Kalifati abasid / Në shtëpinë e dijes



SPECIALE

“Jezu Krishti dhe të tijtë”. E vërteta për familjen e shenjtë

REKLAMA

 CREDINS bank

klloko këtu 

 qed
as distributor